

OBSERVATORI I EKONOMIVE TË PALIGJSHME NË EVROPËN JUGLINDORE

NUMRI

14 SHKURT 2023

Përmbledhje e pikave kryesore



Rritet numri i shqiptarëve që kalojnë Kanalin Anglez me varka të vogla nga Franca.

Që prej korrikut të vitit 2022, numri i madh i shqiptarëve që kalojnë në mënyrë të paligjshme Kanalin Anglez për të ardhur në Mbretërinë e Bashkuar nga Franca ka marrë shumë vëmendje nga media dhe politika britanike, ku fokusi ka qenë përmirësimi i kontrollit kufitar dhe ulja e migracionit të paligjshëm. Në këtë artikull, në bazë të intervistave dhe analizës së të dhënave të ndara, të marra nga faqet e internetit të rrjeteve sociale në gjuhën shqipe, do të shohim se si kryhet ky biznes i paligjshëm, çmimet e tij dhe teknikat që përdoren për reklamë (p.sh. në rrjetet sociale), si dhe faktorët që i nxisin dhe i tërheqin shqiptarët drejt Mbretërisë së Bashkuar.



Grupet kriminale të Ballkanit Perëndimor kontribuojnë në dhunën e ndërlidhur me drogën në Ekuador.

Në vitin 2022, Ekuadori u pllakos nga shpërthimi i dhunës së grupeve të krimit të organizuar, duke përfshirë sulme me bombë, protesta të dhunshme në burgje dhe vrasjen e tre prokurorëve. "Narkodhuna" arriti deri në atë pikë sa që qeveria shpalli gjendjen e

jashtëzakonshme në nëntor të vitit 2022. Ndonëse ky vend i vogël i Amerikës Latine ndodhet më shumë se 10 000 kilometra larg Evropës Juglindore, paqëndrueshmëria e tij rrjedh pjesërisht për shkak të veprimtarive të grupeve kriminale të Ballkanit Perëndimor, të cilat janë bërë faktorë të rëndësishëm të kontrabandimit të kokainës nga Ekuadori drejt Evropës Perëndimore. Mbështetur në analizën e të dhënave parësore nga rajoni, do të shqyrtojmë mënyrën dhe arsyet pse po ndodh kjo dhe do të shpjegojmë pse dhuna aktuale mund të jetë duke i ndihmuar këto grupe që të forcojnë pozitën e tyre në ekonominë joshëse lokale të drogës.



Kosova ndërmerr hapa për të rritur vlerën e pronave të sekuestruara të ndërlidhura me krimin e organizuar.

Legjislacioni penal i Kosovës rregullon konfiskimin e aseteve të siguruara në rrugë kriminale dhe të të ardhurave nga krimi i organizuar, por, deri më tani, arritjet e sistemit të drejtësisë penale në vend kanë qenë fare të pakta. Më tej, ka një mospërputhje të madhe midis vlerës së aseteve të konfiskuara përkohësisht dhe vlerës së atyre



që janë konfiskuar përfundimisht, për shkak të ngurrimit të gjykatave për të nxjerrë vendime për konfiskimin përfundimtar të aseteve dhe të mungesës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të specializuar. Qeveria e Kosovës ka marrë disa hapa për ta mbyllur këtë hendek. A do të arrijnë këto masa të rrisin vlerën e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara? Dhe, duke ndjekur shembullin e vendeve të tjera të rajonit, si Shqipëria dhe Serbia, a mund të bëhet më shumë për të përmirësuar ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara?



Luftëtarët e Ballkanit marrin armët në Ukrainë: rritet rreziku i krimit të organizuar.

Pushtimi i Ukrainës nga Rusia, i cili tashmë ka rreth një vit që vazhdon, u ka dhënë gjallëri ekonomive të paligjshme në këto dy vende, ndërsa pasojat për rajonin, duke përfshirë Evropën Juglindore, janë të rënda. Vëzhguesit, duke përfshirë Iniciativën Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC), e kanë ndjekur këtë situatë nga afër. Megjithatë, ka qenë e paktë vëmendja që u është kushtuar disa mijëra burrave nga Evropa Juglindore që kanë marrë armët për të luftuar në anën e Rusisë ose Ukrainës. Në këtë numër, do të analizojmë këtë dukuri dhe do të shqyrtojmë lidhjet e saj me krimin e organizuar, si dhe sfidat që paraqet kthimi i këtyre luftëtarëve në vendet e tyre në rajon.



Dokumentet ballkanike të rreme ose të siguruara në mënyrë të paligjshme po ua lehtësojnë udhëtimin kriminelëve kudo në botë.

Zyrtarët policorë që hetojnë grupet e krimit të organizuar që veprojnë në Ballkanin Perëndimor ose që vijnë prej tij kanë vënë në dukje herë pas here diçka të ngjashme: lehtësinë me të cilën shumë kriminelë udhëtojnë duke përdorur pasaporta false ose dokumente emigrimi të siguruara në mënyrë të paligjshme, të lëshuara nga vendet e rajonit. Ka dy mënyra me të cilat kriminelët i sigurojnë këto dokumente. Ose modifikojnë fizikisht pasaportën e vlefshme që është vjedhur ose blerë në tregun e zi, duke ndryshuar foton ose të dhënat biografike, ose blejnë në mënyrë të paligjshme një pasaportë të vlefshme me emrin e tyre ose me një nofkë, pasi i kanë dhënë ryshfet një zyrtari të korruptuar. Do të shqyrtojmë arsyet dhe mënyrat në të cilat ekziston ky problem në rajon dhe se çfarë mund të bëhet për ta zbutur atë.



GI-TOC-ja bashkorganizoi një konferencë shkencore në Athinë për të trajtuar mungesën e temave të krimit të organizuar në arsimin e lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ndonëse krimi i organizuar dhe korrupsioni janë sfida madhore në Ballkanin Perëndimor, këto çështje nuk analizohen sa duhet. Ky problem shkaktohet pjesërisht nga mungesa e edukimit për këto tema në arsimin e lartë. Për ta trajtuar këtë problem, GI-TOC-ja bashkorganizoi një konferencë shkencore në Athinë. Këtu po përmbledhim temat kryesore që u trajtuan në takim dhe idetë që duhen ndjekur më pas.

Rritet numri i shqiptarëve që kalojnë Kanalin Anglez me varka të vogla nga Franca.

Që prej korrikut të vitit 2022, shtypi britanik ka ngritur shqetësime në lidhje me numrin në rritje të shqiptarëve që e kapërcejnë në mënyrë të paligjshme Kanalin Anglez duke ardhur nga Franca.¹ Ky numër u rrit nga 50 në vitin 2020 në rreth 13 000 deri në datën 13 dhjetor 2022.² Nga këta, rreth 10 000 janë meshkuj të rritur, të pamartuar, ndërsa 2 000 të tjerët janë gra dhe fëmijë.³ Emigracioni i parregullt nga Shqipëria nuk është diçka e re: Mbretëria e Bashkuar ka qenë prej kohësh magnet për shqiptarët, sidomos për meshkujt në moshë të re. Deri në kohët e fundit, ata hynin kontrabandë, të fshehur në kamionë, pasi e kalonin me vapor Kanalin, por tani shumë emigrantë përpiqen ta kalojnë Kanalin me varka të vogla.

Në nëntor të vitit 2022, Mbretëria e Bashkuar (MB) dhe Shqipëria u përfshinë në një debat publik në lidhje me

hyrjen e madhe të shqiptarëve në MB. Ministria e Brendshme e Mbretërisë së Bashkuar, Suella Braverman (Suella Braverman), iu referua krizës së Kanalit si “pushtim nga bregdeti ynë jugor”,⁴ dhe i cilësoi emigrantët nga Shqipëria si pjesë “të bandave të krimit të organizuar, që paguanin udhëtimin me mjete të pista, ose [...] si njerëz që po vijnë këtu për t’u marrë me veprimtari kriminale, sidomos me drogë.”⁵ Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, replikoi duke shkruar se Qeveria Britanike po i përdorte shqiptarët si kurbanë për të justifikuar dështimin e MB-së në fushën e politikave për emigracionin.⁶

Sigurisht, një prej faktorëve që nxisin emigrimin e shqiptarëve drejt MB-së është mundësia e rekrutimit nga grupet shqiptare të krimit të organizuar, të cilat kërkojnë bashkatdhetarë për të ndihmuar me rritjen e kanabisit në ferma të mbyllura.⁷ Kohët e fundit ka pasur disa arrestime



Emigrantët shtynë drejt ujit një gomone pasi kanë zbarkuar në plazhin e Gravelinit, pranë Dunkirkut, në veri të Francës, më 12 tetor 2022, në përpjekje për të kaluar Kanalin Anglez.

Fotografia: Sameer al-Doumy/AFP nëpërmjet 'Getty Images'

të shqiptarëve që dyshohet se janë drejtues të grupeve të krimit të organizuar, të cilët kanë mundësuar hyrjen e paligjshme të shtetasve shqiptarë në MB për të punuar në fermat e kanabisit.⁸ Janë arrestuar edhe shumë njerëz nga Afganistani dhe Irani duke kaluar Kanalin.⁹

Ndonëse situata me emigrantët shqiptarë ka tërhequr vëmendjen e medias dhe politikës si në Shqipëri, ashtu edhe në Mbretërinë e Bashkuar, pak vëmendje u kushtohet ndryshimeve të metodave që përdoren për kalimin e Kanalit drejt MB-së – më konkretisht, pse ka tani një numër të madh shqiptarësh që rrezikojnë jetën duke kaluar kanalin me varka të vogla në vend që të përdorin rrugët dhe metodat që përdorëshin gjerësisht dikur. Nga analizimi i të dhënave parësore, i kryer nga Global Initiative Against Transnational Organized Crime (Iniciativa globale kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, GI-TOC) në Shqipëri dhe në MB, janë konstatuar disa faktorë prapa këtij ndryshimi, duke përfshirë uljen e kostove dhe ekzistencën e marketingut viral.

Një prej faktorëve kryesorë është çmimi. Sipas atyre që i njohin mënyrat e transportit, kalimi i kanalit me varkë kushton shumë më pak, është më i shpejtë dhe më i lehtë. Ndërsa kontrabandimi me kamion në bordin e tragetit kushton midis 22 500 dhe 28 000 paundësh, lundrimi me varkë të vogël – zakonisht gomone – kushton midis 3 000 dhe 4 500 eurosh. Për të kaluar Kanalin, gjë që është shumë e rëndë dhe e vështirë, shqiptarët zakonisht udhëtojnë me autobus nga Kosova ose Maqedonia e Veriut, pastaj në Serbi, Hungari, Gjermani dhe në fund mbërrijnë në Belgjikë. I gjithë ky itinerar është pak më shumë se 2 200 kilometra. Ky itinerar është itinerari i parapëlqyer, sepse kontrollet në kufirin me Hungarinë konsiderohen më pak të rrepta se gjatë.¹⁰

Më përpara, për të udhëtuar me avion ose në rrugë automobilistike duhej të siguroje pasaportë false dhe të gjeje ndërmjetës. Kjo mënyrë u bë më e rrezikshme me forcimin e kontrolleve kufitare në MB dhe Francë. Tani, në rastin e varkave të vogla, shumë prej aranzhimeve bëhen nëpërmjet rrjeteve sociale. Më tej, ulja me 80% e çmimit duket se e ka hapur tregun. Tani ka më shumë njerëz që janë të gatshëm të rrezikojnë pa iu dashur të marrin kredi të mëdha, të shesin tokë ose bagëti ose të hyjnë në borxhe te trafikantët ose të afërmit, gjëra këto që ndodhnin më përpara.¹¹

GI-TOC-ja ka hasur në disa llogari në rrjetet sociale – sidomos në TikTok – ku reklamohen shërbimet për shqiptarët që duan të shkojnë në MB me varkë.¹² Në

videot e TikTok-ut, që zakonisht janë të shkurtra dhe thumbuese, lexon mesazhe reklamash të tipit: “... për Angli. 4 000 paundë. Me varkë. Çdo ditë” ose “Londra. 100% siguri, pa rrezik dështimi. Te ne, çmimet më të mira në treg.” Në disa postime reklamohen datat e ardhshme të nisjes, ndërsa në të tjerat jepen thjeshtë të dhënat e kontaktit. Shumica e llogarive që ka shqyrtuar ekipi i GI-TOC-së është krijuar gjatë vitit të fundit.¹³

Kjo teknikë reklamimi me kosto fare të ulëta është tërheqëse si për kontrabandistët, ashtu edhe për përdoruesit.¹⁴ Videot prodhohen lehtë, përdorimi i hashtagëve mundëson shpërndarjen e videove në mënyrë virale, të cilat më pas u shfaqen të rinjve që përbëjnë audiencën kryesore të synuar.¹⁵ Algoritmet u mundësojnë kontrabandistëve ta përshtatin materialin për seksionin “Për ty” në TikTok, për audiencën specifike me të cilën dëshirojnë të komunikojnë. Reklamimi në internet u jep trafikantëve njëfarë shkalle fshehtësie, meqë përmbajtja mund të postohet në mënyrë anonime ose nga llogari me emër të rremë. Më tej, të rinjtë joshen nga fotografitë e jetesës së shkëlqyer në Mbretërinë e Bashkuar.¹⁶

Edhe pse reklamat mund të jenë krijuar nga shqiptarët, mendohet se biznesi i kontrabandimit të njerëzve përmes Kanalit drejtohet dhe kontrollohet nga grupet e krimit të organizuar të kurdëve të Irakut.¹⁷ Emigrantët që kërkojnë të kalojnë Kanalin mbliidhen tok në kampe të zakonshme – për shembull, në rrethinat e Dunkirkut të Francës – të cilat kontrollohen nga këto grupe kriminale, dhe presin derisa të vijë ndërmjetësi shqiptar për t’u treguar orën, datën dhe vendin nga ku do të nisen. Atyre u jepet një pajisje me GPS dhe një varkë, të cilën mund ta vozisë një prej emigrantëve të trajnuar.¹⁸

Një prej faktorëve kryesorë nxitës të emigrimit drejt Mbretërisë së Bashkuar është pabarazia ekonomike në Shqipëri, e cila është një prej vendeve më të varfra në Evropë. Në vitin 2022, Shqipëria është renditur vendi i 90-të më i varfër në botë, me PBB prej vetëm 17 858 dollarë për frymë (përshtatur sipas fuqisë relative blerëse).¹⁹ Të ardhurat mesatare vjetore për frymë në Shqipëri janë 6 110 dollarë amerikanë, përkundër 45 380 dollarëve amerikanë në Mbretërinë e Bashkuar.²⁰ Nga një sondazh i fundit në Ballkan doli që për 59% të shqiptarëve, gjendja e vështirë ekonomike e vendit është shqetësimi i tyre kryesor.²¹ Të rinjtë, që nuk gjejnë mundësi në atdhe, do t’i gjejnë jashtë tij.²²



FIGURA 1 Itinerari nga Shqipëria në MB.



Varkë e vogël e mbushur me njerëz shpëtohet në ujërat angleze në datën 13 nëntor 2022.

Fotografia: Andrew Aitchison/In pictures nëpërmjet 'Getty Images'

Më tej, diaspora e madhe shqiptare në MB është magnet për bashkatdhetarët. Shumë sipërmarrës shqiptarë në MB i japin përparësi punësimit të të afërmeve të tyre.²³ Ndonëse medieve u pëlqen të nënvizojnë statistikën që ka më shumë se 1 000 shqiptarë në burgjet e MB-së, ia vlen të përmendim se, sipas kryeministrit Edi Rama, shqiptarët drejtojnë rreth 1 200 biznese në Mbretërinë e Bashkuar.²⁴

Vihet re që kriminelët që organizojnë tregun e kontrabandimit duket se po shënjestrojnë gratë, me argumentin se atyre ka më shumë mundësi t'u pranohen kërkesat për azil. Edhe pse, në përgjithësi, shqiptarët kanë pak mundësi të përfitojnë azil,²⁵ kërkesat për azil që bëhen nga gratë dhe fëmijët kanë 90% sukses (ndërsa meshkujt 14%).²⁶

Për ta zgjidhur këtë krizë politikisht të ngarkuar do të duhet të ketë më shumë bashkëpunim praktik midis

vendeve të përfshira dhe jo akuzat e ndërsjella publike. Këtu përfshihen përpjekjet e përbashkëta të agjencive ligj-zbatuese të Shqipërisë, Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar, për të gjetur dhe shkatërruar rrjetet e kontrabandimit. Gjithashtu, do të duhet të krijohen më shumë opsione të ligjshme për shqiptarët që kërkojnë të punësohen në Mbretërinë e Bashkuar (p.sh. mundësi për punë sezonale), të zhvillohen fushata për edukimin e popullsisë në lidhje me rreziqet e udhëtimit dhe të bëhen përpjekje për të hapur më shumë vende pune në Shqipëri. Më tej, është e rëndësishme të ulet joshja e rinisë shqiptare nga përfshirja në krim, duke forcuar qëndrueshmërinë në komunitetet e largëta dhe duke u ofruar të rinjve mundësi të mjaftueshme për t'u arsimuar dhe punësuar në atdhe. Këto lloj nismash janë duke u ndërmarrë, por jo në masën që duhet.

Shënime

- 1 Mark Hookham, 4 in 10 migrants from peaceful Albania, not war-torn states, *Daily Mail*, 6 gusht 2022, <https://www.mailplus.co.uk/edition/news/209513/4-in-10-migrants-from-peaceful-albania-not-war-torn-states?contentLayout=5pm%20Front%20Page>.
- 2 *Albanian migrants: Why are they coming to the UK and how many have arrived?*, BBC, 14 janar 2023, <https://www.bbc.com/news/explainers-63473022>.
- 3 UK Parliament, Home Affairs Committee, *Channel crossings*, 26 tetor 2022, <https://parliamentlive.tv/event/index/6c665bd9-85e6-44d4-bab7-6724f0da117a>.
- 4 *UK home secretary slammed for asylum seeker 'invasion' remarks*, Al Jazeera, 1 nëntor 2022, <https://www.aljazeera.com/news/2022/11/1/uk-home-secretary-slammed-for-asylum-seeker-invasion-remarks>.
- 5 Rajeev Syal dhe Aina J Khan, *Britain is targeting Albanians to excuse policy failures, says country's PM*, *The Guardian*, 2 nëntor 2022, <https://www.theguardian.com/politics/2022/nov/02/britain-is-targeting-albanians-to-excuse-policy-failures-says-countrys-pm-edi-rama>
- 6 Po aty.
- 7 Rajeev Syal, *Rise in Albanian asylum seekers may be down to criminal gangs*, *The Guardian*, 25 gusht 2022, <https://www.theguardian.com/uk-news/2022/aug/25/rise-in-albanian-asylum-seekers-may-be-down-to-criminal-gangs>.
- 8 National Crime Agency, *Alleged head of organized crime group arrested*, *WiredGov*, 25 mund 2022, <https://www.wired-gov.net/wg/news.nsf/articles/Alleged+head+of+organised+crime+group+arrested+25052022100500?open>
- 9 Amelia Gentleman, *Afghans with western links among rising number trying to cross Channel*, *The Guardian*, 3 qershor 2022, <https://www.theguardian.com/world/2022/jun/03/afghans-western-links-among-rising-number-trying-cross-channel>.
- 10 Ervisa Qefa, 'Lutem të kemi ndonjë që di të drejtojë gomonen', 'Piranjat' zbulojnë hap pas hapi kalvarin e shqiptarëve drejt Anglisë, *ABC News*, 9 tetor 2022, <https://abcnews.al/lutem-te-kemi-ndonje-qe-di-te-drejtoje-gomonen-piranjat-zbulojne-hap-pas-hapi-kalvarin-e-shqiptareve-drejt-anglise>.
- 11 *He fled to England illegally, the Albanian confesses and shows the difficulties: We ran out of gas in the middle of the ocean*, *Sot News*, 19 tetor 2022, <https://sot.com.al/english/aktualitet/iku-ilegalisht-ne-angli-rrefehet-shqiptari-dhe-tregon-veshtersite-na-i543654>.
- 12 Për shembuj të videoeve në TikTok ku reklamohen shërbimet e shkuarjes në MB me varkë, shih: https://www.tiktok.com/@unitedkingdom07/video/7104187482106875141?_t=8Wp2NDGvM5W&_r=1; https://www.tiktok.com/@dunkerque_dover_trip/video/7106917693130902790?_r=1&_t=8Wp2Ppfkcll&is_from_webapp=pv1&item_id=7106917693130902790; https://www.tiktok.com/@noldmuja/video/7126582018049068294?_r=1&_t=8Wp2RoeK3hl&is_from_webapp=v1&item_id=7126582018049068294.
- 13 Fjori Sinoruka, *Rise in TikTok ads among Albanians selling smuggling operations to UK*, *BalkanInsight*, 8 gusht 2022, <https://balkaninsight.com/2022/08/08/rise-in-tiktok-ads-among-albanians-selling-smuggling-operations-to-uk>.
- 14 Oliver Harvey, *TikTok traffickers: People traffickers using TikTok to sell £4.5k Channel crossings to Albanians – insisting 'the French won't stop you'*, *The Sun*, 8 gusht 2022, <https://www.thesun.co.uk/news/19454541/albanian-people-smugglers-tiktok; Albanian migrants offered 'TikTok Black Friday' deals by people smugglers ahead of Govt crackdown>, *LBC*, 27 gusht 2022, <https://www.lbc.co.uk/news/albanian-tiktok-deals-people-smugglers; Mat Dathan, Crossing the Channel is easy, says Albanian child in TikTok advert, The Times>, 24 shtator 2022, <https://www.thetimes.co.uk/article/crossing-the-channel-is-easy-says-albanian-child-in-tiktok-advert-xfmgshdm>.
- 15 Start.io, *TikTok users in Albania*, gusht 2022, <https://www.start.io/audience/tiktok-users-in-albania>.
- 16 'They think they will find paradise, but ...': the strong warning from *The Times*: In five years Albania will be empty, *Sot News*, 4 nëntor 2022, <https://sot.com.al/english/aktualitet/mendojne-se-dogjejne-parajsen-por-paralajmerimi-i-forte-nga-the-time-i547067>.
- 17 'Piranjat' sjellin kalvarin e vuajtjeve që shqiptarët kalojnë për të mbërritur në Britani, *ABC News*, 16 tetor 2022, <https://www.youtube.com/watch?v=JMI9OmFHlul>.
- 18 250 euro batanija, 'Piranjat' vizitojnë kampin e shqiptarëve në Francë, biseda me trafikantin nga Vlora që u "premtan" klandestinëve ëndrrën angleze, *ABC News*, 2 tetor 2022, <https://abcnews.al/250-euro-batanija-piranjat-vizitohet-kampin-e-shqiptareve-ne-france-biseda-me-trafikantin-nga-vlora-qe-u-premtan-klandestineve-endrren-angleze>.
- 19 International Monetary Fund, *World Economic Outlook Database*, tetor 2022, <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/weo-database/2022/October>.
- 20 World Data, *Country comparison*, <https://www.worlddata.info/country-comparison.php?country1=ALB&country2=GBR>.
- 21 Po aty.
- 22 Anesa Agović dhe Walter Kemp, *Resilient Balkans: Strengthening resilience of youth to organized crime*, *GI-TOC*, prill 2022, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2022/02/GMFA-Strengthening-Resilience-of-Youth-to-Organized-Crime-ENG-web.pdf>.
- 23 Edi Rama, *Twitter*, 2 nëntor 2022, <https://twitter.com/ediramaal/status/1587800225980129280>.
- 24 Giada Kuka, *Rama to British official: Albanians are not criminals, they run businesses in Britain*, *Euronews*, 3 nëntor 2022, <https://euronews.al/en/rama-to-british-official-albanians-are-not-criminals-they-run-businesses-in-britain>.
- 25 UK Home Office, *Factsheet: Small boat crossings since July 2022*, 2 nëntor 2022, <https://www.gov.uk/government/statistics/factsheet-small-boat-crossings-since-july-2022/factsheet-small-boat-crossings-since-july-2022>.
- 26 Po aty.

Grupet kriminale të Ballkanit Perëndimor kontribuojnë në dhunën e ndërlidhur me drogën në Ekuador.

Në vitin 2022, Ekuadori u pllakos nga shpërthimi i dhunës së grupeve të krimit të organizuar, duke përfshirë sulme me bombë, protesta të dhunshme në burgje dhe vrasjen e tre prokurorëve. “Narkodhuna” arriti deri në atë pikë sa që qeveria shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në nëntor të vitit 2022. Ndonëse ky vend i vogël i Amerikës Latine ndodhet mijëra kilometra larg Evropës Juglindore, paqëndrueshmëria e tij vjen pjesërisht si pasojë e veprimtarive të grupeve kriminale të Ballkanit Perëndimor, të cilat janë bërë faktorë të rëndësishëm të kontrabandimit të kokainës nga Ekuadori drejt Evropës Perëndimore. Në vend që të çojë në ndërprerjen e veprimtarive të tyre, dhuna e kohëve të fundit në Ekuador mund të jetë duke i ndihmuar këto grupe që të forcojnë pozitën e tyre në ekonomikë joshëse lokale të drogës.

Faktorë të rëndësishëm në një portal të madh kokaine

Ekuadori, i cili gjendet midis dy vendeve kryesore të prodhimit të kokainës, Kolumbia dhe Peruja, është bërë portal kryesor për dërgimin me anije të kokainës drejt Evropës.¹ Porti i Guajakilit, më i madhi në Ekuador, është njëherazi pikë e rëndësishme nisjeje për drogat dhe epiqendër e dhunës që ndërlidhet me drogën. Midis janarit dhe gushtit të vitit 2022, në Ekuador janë regjistruar 145 sulme me bombë, gjysma e të cilave ndodhën në Guajakil.² Qytetin e kanë pllakosur dhuna e bandave, vrasjet makabre, rrëmbimet dhe zhvatja. Në shumë raste – për shembull, në gusht të vitit 2021 – qeveria është detyruar të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme për shkak të dhunës.³



Porti i Guajakilit në Ekuador është epiqendra e dhunës së ndërlidhur me drogën.

Fotografia: Michele Westmorland

Dhuna ka përfshirë edhe burgjet, ku grupet kriminale bashkërendojnë trafikimin e kokainës.⁴ Në vitin 2021, rreth 316 të burgosur u vranë në burgjet e vendit, të cilat shpesh janë të mbipopulluara. Kjo prirje vazhdoi edhe në vitin 2022, duke përfshirë një përlëshje të përgjakshme në tetor, e cila mendohet se është nxitur nga një përpjekje për pushtet mbi rrjetet e shpërndarjes së drogës.⁵

Për njëfarë kohe, Ekuadori ka vuajtur nga paqëndrueshmëria politike dhe drejtësia e dobët penale dhe konsiderohet si një prej demokracive më të paqëndrueshme të Amerikës Latine.⁶ Në vitin 2021, ky shtet zuri vendin e 31-të në botë në Indeksin Global të Krimin të Organizuar.⁷ Një prej pikëve më të larta të kriminalitetit (7,5 nga 10) kishte të bënte me ndikimin e faktorëve të huaj. Disa prej faktorëve të huaj më të fuqishëm dhe më të dhunshëm janë grupet kriminale nga Meksika, të cilët transportojnë kokainë nga Ekuadori drejt Shteteve të Bashkuara.⁸ Megjithatë, në Ekuador veprojnë edhe grupet kriminale nga Ballkani Perëndimor. Ndonëse kanë arritur të mos bien në sy, prania dhe veprimtaria e tyre ka lënë gjurmë gjaku. Gjatë pesë viteve të fundit, në Ekuador janë vrarë pesë shtetas të Ballkanit: tre shqiptarë, një serb dhe një malazez. U plagos edhe një qytetar i Kosovës. Të gjitha këto raste besohet se kanë lidhje me trafikimin e kokainës dhe me mosmarrëveshjet në radhët e faktorëve të huaj dhe midis këtyre dhe bandave kriminale lokale.⁹

Mendohet se pjesa më e madhe e narkodhunës në Ekuador ka të bëjë me konkurrencën midis grupeve lokale në lidhje me atë se cili do t'u ofrojë mbrojtje faktorëve të fuqishëm të huaj.¹⁰ Grupet kriminale nga Ballkani punojnë ngushtë me bandat lokale për të garantuar mbarëvajtjen e veprimtarisë së tyre. Për shembull, grupet lokale ndihmojnë me sigurimin e kokainës, transportin, logjistikën dhe sigurinë dhe krijojnë lidhjet me politikanët e korruptuar dhe me aleatët në sektorin e sigurisë dhe në sistemin e drejtësisë. Meqë ky biznes është mjaft fitimprurës, sipërmarrësit lokalë konkurrojnë midis njëri-tjetrit, duke përfshirë edhe përdorimin e dhunës.

Deri më tani, sistemi i drejtësisë penale në Ekuador nuk ka arritur ta vërë nën kontroll situatën. Intervistat me zyrtarët e lartë të policisë në Ekuador tregojnë se ata nuk i njohin sa duhet grupet kriminale të Ballkanit Perëndimor dhe se bashkëpunimi i tyre me homologët në Evropën Juglindore është i paktë. Gjithashtu, ekziston edhe një historik korruptimi. Shpesh, ata që

guxojnë të ngrihen kundër krimit e pësojnë. Në vitin 2022 u vranë tre prokurorë ekuadoras: dy në Manabi dhe një në Guajakil.¹¹

Grupet nga Ballkani përfitojnë nga kriza

Çuditërisht, vala më e fundit e dhunës mund të jetë mundësi e mirë për grupet kriminale të Ballkanit Perëndimor që veprojnë në Ekuador. Së pari, ata nuk janë shënjestër e dhunës. Në fakt, bandat lokale ekuadorase luftojnë për të mbrojtur grupet kriminale të Ballkanit Perëndimor dhe mundësojnë veprimtaritë e këtyre të fundit, dhe kështu përfitojnë bandat ekuadorase. Nëse grupet ballkanase nuk bien në sy dhe notojnë me valën, ato mund të përfitojnë nga rivaliteti i ashpër midis bandave, për ta blerë kokainën me çmim më të ulët dhe për të gjetur sipërmarrës të dhunshëm që janë të gatshëm t'u ofrojnë mbrojtje.

Së dyti, dhuna në rrugë dhe në burgje bën që policia të jetë e zënë me punë, gjë që u mundëson faktorëve të huaj të përfitojnë nga situata. Identifikimi i trafikantëve ballkanas në vendet e Amerikës Latine nuk ka qenë i drejtpërdrejtë. Kjo falë identiteteve të tyre të shumta (duke përfshirë edhe përdorimin e dokumenteve false), korrupsionit dhe lidhjeve me njerëz të pushtetshëm. Vala e re e dhunës ia bën edhe më të vështirë zyrtarëve të agjencive ligj-zbatuese që të shënjestrojnë grupet e huaja kur i kanë duart të zëna me grupet e dhunshme të vendit të tyre.

Së treti, grupet kriminale nga Ballkani përfitojnë nga rrëmuja e përgjithshme që ka pllakosur Ekuadorin si pasojë e rritjes së dhunës. Raportohet se kufijtë po bëhen gjithmonë e më të depërtueshëm dhe siguria portuale më pak e rreptë. Rrëmuja u ka mundësuar kriminelëve të dalin nga rrjeta e sistemit të drejtësisë. Për shembull, trafikanti famëkeq shqiptar i drogës, Dritan Rexhepi, që ka qenë në burg në Ekuador që prej vitit 2014, përfitoi arrest shtëpiak në fund të vitit 2021. Sipas medieve, nga ai vit ai është zhdukur nga shtëpia në Guajakil për të vazhduar me veprimtaritë kriminale.¹²

Dhuna e kohëve të fundit në Ekuador tregon natyrën ndërkombëtare të krimit të organizuar dhe faktin që zbatimimi i ligjit në arenën ndërkombëtare është në gjendje të copëzuar. Zyrtarët e zbatimit të ligjit në Evropën Perëndimore dhe Juglindore nuk do të kenë mundësi të ndërpresin dërgesat e mëdha të drogës, përveç nëse bashkëpunojnë më shumë me homologët e tyre në vendet burimore siç është Ekuadori. Ndërkohë, policia në Ekuador do ta ketë të vështirë të

ulë dhunën në vend, përveç nëse e kuptojnë që narkodhuna po nxitet, pjesërisht, nga konkurrenca midis grupeve lokale për të mbrojtur faktorët kriminalë të huaj. Thënë ndryshe, ky është shembull i mirë i një

problemi “glokal”, ku flukset botërore ndikojnë te gjendja lokale. Për këtë arsye, zgjidhja duhet të jetë e bashkërenduar dhe shumëpalëshe.

Shënime

- 1 Walter Kemp, *Transnational tentacles: Global hotspots of Western Balkan organized crime*, GI-TOC, korrik 2020, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/07/Transnational-Tentacles-Global-Hotspots-of-Balkan-Organized-Crime-ENGLISH_MRES.pdf.
- 2 International Crisis Group, *Ecuador's high tide of drug violence*, 4 nëntor 2022, <https://www.crisisgroup.org/latin-america-caribbean/andes/ecuador/ecuadors-high-tide-drug-violence>.
- 3 Dan Collins, *Ecuador city declares state of emergency amid dramatic rise in gang bombings*, *The Guardian*, 15 gusht 2022, <https://www.theguardian.com/world/2022/aug/15/ecuador-state-emergency-guayaquil-rise-bombings-gangs-cocaine>.
- 4 *UN experts sound alarm as Ecuador sees more deadly prison clashes*, Al Jazeera, 6 tetor 2022, <https://www.aljazeera.com/news/2022/10/6/un-experts-sound-alarm-as-ecuador-sees-more-deadly-prison-clashes>.
- 5 Associated Press, *Ecuador prison clash leaves at least 15 dead, 20 injured*, VOA News, 4 tetor 2022, <https://www.voanews.com/a/ecuador-prison-clash-leaves-at-least-15-dead-20-injured/6774888.html>.
- 6 Walter Kemp, *Transnational tentacles: Global hotspots of Western Balkan organized crime*, GI-TOC, korrik 2020, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/07/Transnational-Tentacles-Global-Hotspots-of-Balkan-Organized-Crime-ENGLISH_MRES.pdf.
- 7 Shih: GI-TOC, *Global Organized Crime Index – Criminality in Ecuador*, <https://ocindex.net/country/ecuador>.
- 8 Dan Collins, *Agony of Ecuador's brutal prison massacre endures for bereaved relatives*, *The Guardian*, 10 tetor 2021, <https://www.theguardian.com/global-development/2021/oct/10/ecuador-prison-massacre-relatives>.
- 9 Alessandro Ford, *Albanian mafia leaves trail of blood in Ecuador*, InSight Crime, 5 janar 2021, <https://insightcrime.org/news/analysis/adriatik-tresa-albanian-mafia-ecuador; European mafias operate from Ecuador, even from prison they coordinate the exit of the drug>, 24/7 News Agency, 6 shkurt 2022, <https://247newsagency.com/opinion/60609.html>.
- 10 Intervistë me një gazetar investigativ në Bogota, shtator 2022.
- 11 Inci Sayki, *Two charged for the killing of Ecuadorian prosecutor*, OCCRP, 21 shtator 2022, <https://www.occrp.org/en/daily/16787-two-charged-for-the-killing-of-ecuadorian%20prosecutor>.
- 12 *Judge let the 'cocaine czar' escape in Ecuador*, *Ecuador Times*, 11 nëntor 2022, <https://www.ecuadortimes.net/judge-let-the-cocaine-czar-escape-in-ecuador>.

Kosova ndërmerr hapa për të rritur vlerën e pronave të sekuestruara të ndërlidhura me krimin e organizuar.

Edhe pse legjislacioni penal i Kosovës rregullon konfiskimin e aseteve të siguruara në rrugë kriminale dhe të të ardhurave nga krimi i organizuar, arritjet e sistemit të drejtësisë penale në vend, deri tani, kanë qenë të pamjaftueshme. Nga analiza e të dhënave për vitet 2017-2021, del se 6,3 milionë euro asete janë konfiskuar në 28 raste, duke përfshirë trafikim të lëndëve narkotike, kontrabandim mallrash dhe trafikim armësh. Megjithatë, statistikat tregojnë edhe një mospërputhje të madhe midis vlerës së aseteve të sekuestruara përkohësisht dhe vlerës së atyre që janë konfiskuar përfundimisht (në mënyrë të përhershme). Për ta mbyllur këtë hendek, qeveria e Kosovës ka marrë një numër hapash, ku përfshihet krijimi i Byrosë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme dhe parashikimi me ligj i konfiskimit të aseteve jo mbi bazën e dënimit për veprën penale. A do të arrijnë këto masa të rrisin vlerën e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara? Dhe, duke ndjekur shembullin e vendeve të tjera të rajonit, si Shqipëria dhe Serbia, a mund të bëhet më shumë për të përmirësuar ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara?

Mospërputhshmëria midis vlerës së aseteve të sekuestruara dhe asaj të aseteve të konfiskuara

Rikuperimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi i organizuar i pengojnë kriminelët të përfitojnë pasurinë e vënë nëpërmjet veprimtarive penale. Në teori, kjo duhet të veprojë si mjet për të dekurajuar krijimin, sepse rrit rreziqet dhe ul përfitimet nga veprimtaritë e paligjshme. Megjithatë, në Kosovë, pavarësisht legjislacionit dhe institucioneve të ngritura, asetet e konfiskuara kanë qenë të pakta. Për të rritur konfiskimin e aseteve dhe për të çuar më tutje legjislacionin, në vitin 2019 hyri në fuqi një ligj me të cilin bëhej e mundur zgjerimi i konfiskimit.

Konfiskimi standard rregullohet me Kodin e Procedurës Penale (KPP). Autoritetet mund të mbështeten në këtë kod për të konfiskuar asetet dhe përfitimet materiale që janë siguruar nga veprat penale për të cilat personi është shpallur fajtor (shih kutizën: Kuadri kryesor legjislativ dhe institucional për konfiskimin e aseteve). Nga ana tjetër, zgjerimi i konfiskimit mund të përdoret atëherë kur dispozitat e KPP-së nuk mjaftojnë. Kështu, mund të

konfiskohen asete që nuk kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën personi në fjalë është shpallur fajtor. Konfiskimi i përkohshëm, në aspektin procedural, kryhet me kërkesën e prokurorit të shtetit dhe me miratimin e gjyqtarit të procedurës paraprake. Krahas kësaj, prokurorët kanë mundësinë të marrin masa hetimore për të ngrirë përkohësisht asetet ose për të nxjerrë urdhra kufizues të vlefshëm për 72 orë, me qëllim parandalimin e shitjes, transferimin e pronësisë ose tërheqjen nga llogaria.¹

Siç tregohet në figurën 1, të dhënat për periudhën 2014-2021 tregojnë një mospërputhje prej 185,98 milionë eurosh midis vlerës së aseteve të sekuestruara dhe vlerës së aseteve të konfiskuara përfundimisht.² Me fjalë të tjera, vetëm 3,3% e aseteve të sekuestruara janë konfiskuar përfundimisht. Në nivelin e BE-së, përqindja është rreth 50.³ Gjëja më e rëndësishme është që, edhe pse me ligjin “Për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale” prokurorëve u janë dhënë më shumë burime,⁴ që kur ligji hyri në fuqi në vitin 2019 nuk ka pasur asnjë rast.⁵

Gjatë periudhës 2017-2021, janë kryer vetëm 28 konfiskime nga 1 695 raste të aseteve të sekuestruara (ose 2%), siç tregohet në figurën 2. “Shumë raste janë ende në faza të ndryshme të gjykimit, për shkak të vonesës së procedurave gjyqësore, ngurrimit të gjykatave për marrë vendime për shitjen e aseteve dhe mungesës së gjyqtarëve të specializuar”, u shpreh Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike.⁶ Nga ana tjetër, një gjyqtar i Gjykatës së Apelit nënvizoi mungesën e hetimeve me bazë në prova dhe ndjekjes së rasteve sipas ligjit për konfiskimin e zgjeruar, si dhe mangësi në zbatimin dhe interpretimin e saktë të standardeve përkatëse.⁷ Mungesa e rezultateve u theksua nga ekspertë të lartë të pavarur nga shtetet anëtare të BE-së gjatë misionit vlerësues në Kosovë në lidhje me luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit. Ekspertët kanë vënë re se nuk përdoret as konfiskimi në bazë të vlerës, as konfiskimi me palë të tretë dhe as konfiskimi i zgjeruar, dhe se mungon vullneti i sistemit gjyqësor për të bërë përparim të prekshëm.⁸

SISTEMI LEGJISLATIV NË KOSOVË

Kodi Penal

Konfiskimi i mjeteve dhe i perfitimeve materiale që janë fituar me anë të veprës penale rregullohet me nenin 92. Krahas kësaj, kur konfiskimi është i pamundur, autori i veprës urdhërohet të paguajë shumën e barasvlershme ose i konfiskohet një pasuri me vlerë të barasvlershme.



Ligji "Për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë"

Me këtë ligj rregullohet konfiskimi i zgjeruar i pasurisë atëherë kur nuk mjaftojnë procedurat që parashikohen në Kodin e Procedurës Penale. Ky ligj zbatohet për personat e dënuar për vepra penale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale ose në ligje të tjera, për çdo vepër penale prej së cilës janë nxjerrë perfitime materiale me vlerë më të madhe se 10 000 euro, kur personi ka vdekur, është arratisur nga vendi, nuk mund të gjurmohet ose vuan nga ndonjë aftësi e kufizuar mendore ose fizike.

Kodi i Procedurës Penale

Ky kod ka disa dispozita me të cilat rregullohet konfiskimi i pasurisë, domethënë sekuestrimi i përkohshëm (neni 112), konfiskimi i përhershëm (neni 115), ngrirja e përkohshme e aseteve (nenet 264-266) dhe masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë (nenet 268-284).



Ligji "Për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar"

Ky ligj rregullon funksionimin e Agjencisë, menaxhimin, shitjen dhe dhënien me qira të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, bashkëpunimin me institucionet e tjera dhe fusha të tjera që parashikohen me ligj.



INSTITUCIONET KRYESORE NË KOSOVË



Gjykatat

Sipas Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal, midis të tjerash, gjykojnë kërkesat për konfiskim të përkohshëm, ngrirje të pasurisë dhe konfiskimin përfundimtar. Nga ana tjetër, në përputhje me ligjin "Për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë" marrin vendime për konfiskimin e zgjeruar.



Koordinatori Kombëtar Kundër Krimin Ekonomik

Koordinon dhe monitoron zbatimin e veprimtarive dhe planveprimave, mblledh dhe analizon të dhëna, përgatit raporte tremujore, jep rekomandime dhe kryen veprimtari të tjera të rëndësishme.



Policia e Kosovës

Kryen hetime, mblledh prova, identifikon dhe sekuestron pasuritë dhe kryen detyra të tjera të rëndësishme.



Prokuroria

Vendos të nisë hetime dhe i drejton ato, bën kërkesa për sekuestrimin e përkohshëm dhe ngrirjen e përkohshme të aseteve, ngre aktakuzat për të kërkuar konfiskim të përhershëm të aseteve etj.



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar

Administron dhe ruan pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar, zbaton urdhrat gjyqësorë, bën vlerësimin e pasurisë, shkëmben informacione me institucionet e tjera dhe kryen detyra të tjera të rëndësishme.



Kuadri kryesor legjislativ dhe institucional për konfiskimin e aseteve, Kosovë.

Vlera më e lartë e aseteve të sekuestruara u arrit në vitin 2016, ku, në dy operacione të mëdha, u sekuestruan asete me vlerë të përgjithshme midis 60,4 milionë dhe 70,4 milionë eurosh. Prokuroria e Shtetit hapi një rast për lëshimin e 65 pronave të zëna në mënyrë të paligjshme, me vlerë të përgjithshme pak më të vogël se 42 milionë euro.⁹ Nga ana tjetër, atë vit, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

(EULEX) sekuestroi 39 parcela me vlerë të përgjithshme midis 15 milionë dhe 25 milionë eurosh.¹⁰




FIGURA 1 Mospërputhja midis vlerës së asetëve të sekuestruara dhe të ngrira dhe vlerës së konfiskimeve të përhershme.

Burimi: Këshilli Prokurorial i Kosovës




FIGURA 2 Numri i rasteve asetëve të sekuestruara, ngrira dhe konfiskuara

Burimi: Prokuroria

Administrimi i asetëve të sekuestruara ose të konfiskuara

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK), si institucion ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, ruan dhe administron asetet e sekuestruara dhe të konfiskuara.¹¹ Aktualisht, në AAPSK janë punësuar 26 vetë. Pozicioni i drejtorit të përgjithshëm është i lirë që prej prillit të vitit 2021.

Në një raport të vitit 2022 për ripërdorimin social të asetëve të konfiskuara, të botuar nga GI-TOC-ja, u identifikuan disa sfida në vendet e Ballkanit Perëndimor, disa prej të cilat janë më të dukshme në Kosovë. Këtu përfshihet transparenca e pamjaftueshme në administrimin dhe transferimin e asetëve të konfiskuara dhe mungesa e dispozitave që mundësojnë ripërdorimin social të tyre dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile.¹² Ligji aktual nuk parashikon ripërdorimin social të asetëve të konfiskuara për qëllime publike, prandaj qeveria i ripërdor asetet vetën për të kompensuar palët e dëmtuara. Më tej, transferimi i asetëve të konfiskuara nuk rregullohet me asnjë akt nënligjor ose procedurë standarde të veprimit.

AAPSK-ja nuk e ka krijuar ende faqen e internetit. Informacionet që jepen në faqen e internetit të ministrisë kanë vetëm disa fakte bazë, mandatin dhe kompetencat e Agjencisë dhe një link për thirrjet për ankand. Deri në prill të vitit 2022, janë botuar 67 thirrje.¹³ Megjithatë, nuk ka të dhëna publike në lidhje me përfundimet e këtyre ankandëve.

Zhvillimet e reja

Mungesa e rezultateve lidhur me konfiskimin e përhershëm të asetëve e ka bërë qeverinë e re të nisë në vitin 2021 një projektligj për krijimin e Byrosë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme dhe të parashikojë konfiskimin jo në bazë të veprës për të cilën dënohet i pandehuri.¹⁴ Pasi të hyjë në fuqi, ky ligj do të mundësojë konfiskimin e pasurisë së fituar në rrugë të paligjshme në procedurë civile dhe në mungesë të dënimit penal. Kur byroja, gjatë procedurave të verifikimit, vëren ndonjë mospërputhje më të madhe se 25 000 euro midis të ardhurave dhe asetëve, ajo e dërgon rastin në gjykatë për nisjen e procedurave civile të konfiskimit.¹⁵ Ky ligj do të zbatohet vetëm për personat zyrtarë,¹⁶ anëtarët e familjes së tyre, personat e ekspozuar politikisht dhe palët e treta, dhe do t'i mundësojë Byrosë të konfiskojë pasurinë e pajustificuar, të vënë që prej vitit 2008, deri në 10 vjet pas mbarimit të detyrës së tyre zyrtare.¹⁷

Në tetor të vitit 2021, Komisioni Evropian vuri në dukje se projektligji duhet të jetë në përputhje me kushtetutën dhe të drejtat themelore dhe të parashikojë masa të qarta mbrojtëse kundër keqpërdorimit ose abuzimit të mundshëm.¹⁸ Projektligji i ri është shqyrtuar me kujdes nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, i cili ka konstatuar se janë të pamjaftueshme masat për të siguruar pavarësinë e Byrosë dhe se ekzistojnë shqetësime në lidhje me sigurimin e provave në kuadër të procedurës së konfiskimit.¹⁹ Partitë opozitare e kanë kundërshtuar projektligjin duke thënë se ai bie ndesh me kushtetutën dhe nuk ka dispozita për të siguruar pavarësinë nga ndërhyrjet politike.²⁰ Për pasojë, kryetari i Kuvendit, në përputhje me kërkesën e partive opozitare, e dërgoi projektligjin në Komisionin e Venedikut për t'i kërkuar opinion. Më 20 qershor 2022, komisioni doli me opinionin e tij ku identifikoi një numër mangësish që mund të çojnë në shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe me Kartën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Më tej, Komisioni argumentoi se, nëse qeveria e krijon Byronë, ajo duhet të japë garanci të forta për pavarësinë e Byrosë, të sigurojë një numër të mjaftueshëm personeli të specializuar dhe të parashikojë kompetenca të mjaftueshme.²¹ Kuvendi e miratoi projektligjin në korrik të vitit 2022, pas leximit të parë. Mbetet të shihet se si do të trajtohen rekomandimet e Komisionit të Venedikut përpara miratimit të dytë dhe përfundimtar.²²

Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike e mbështet këtë nismë, të cilën e sheh si pjesë të rëndësishme të plotësimit të kuadrit ligjor. Megjithatë, ai vuri në dukje se kufizimi i fushëveprimit të ligjit vetëm te personat zyrtarë, anëtarët e familjeve të tyre, personat e ekspozuar politikisht dhe palët e treta është mangësi e madhe.²³

Në të njëjtën kohë, qeveria është duke krijuar një fond konfiskimi dhe ka miratuar "Koncept-dokumentin për fondin e konfiskimit" në qershor të vitit 2022.²⁴ Do të krijohet një grant qeveritar në kuadër të AAPSK-së, i cili do të mundësojë ripërdorimin e asetëve për qëllime sociale dhe për nevojat e institucioneve, duke përfshirë veprimtaritë për ngritjen e kapaciteteve.²⁵ Nga projektligji përfundimtar i miratuar është hequr propozimi fillestar që një pjesë e caktuar e fondit të konfiskimit t'u jepej viktimave, institucioneve të gjyqësorit dhe agjencive ligj-zbatuese, buxhetit të shtetit dhe të përdorej për ripërdorim social.²⁶ Kriteri për zbatimin dhe shpërndarjen e fondeve dhe asetëve duhet të rregullohet me ligjin e ri ose me akt nënligjor, me të




FIGURA 3 Asetet e paluajtshme të sekuestruara dhe të konfiskuara në Kosovë, që janë në administrimin e AAPSK-së deri në prill të vitit 2022.

Burimi: AAPSK

cilin duhet të sigurohet transparenca dhe llogaridhënia si dhe vendimmarrja e paanshme. GI-TOC-ja, në një raport për ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara, jep disa shembuj të mirë nga vendet e rajonit, të cilat mund të shërbejnë si frymëzim për Kosovën.²⁷

Hapat e radhës

Për të përmirësuar rezultatet, duhet t'i jepet përparësi konfiskimit të aseteve, sidomos nga prokuroria dhe sistemi gjyqësor. Rezultatet e punës të Prokurorisë duhet të përmirësohen duke ngritur dhe zbatuar me rreptësi një sistem me synime dhe tregues specifikë për konfiskimin e aseteve. Gjithashtu, duhet të zhvillohen më shumë trajnime të përbashkëta për agjencitë ligj-zbatuese, prokurorët dhe gjykatësit. Është e rëndësishme që zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike të plotësohet e gjitha me personelin e duhur, me përfaqësues të agjencive ligj-zbatuese, në përputhje me rregulloren, me qëllim që të zbatojë mandatin në mënyrë efektive.

Shënime

- 1 Code no.04/L-123 Procedure Code, Official Gazette of the Republic of Kosovo, 28 dhjetor 2012, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.
- 2 Në vitin 2016, vlera e aseteve të sekuestruara dhe të ngrira ishte midis vlerave 60 411 328 dhe 70 411 328 euro. Për qëllime të analizës dhe të paraqitjes grafike të të dhënave (grafiku 1), u zgjodh një vlerë mesore (65 511 328 euro).
- 3 EUROPOL, *Does crime still pay? Criminal asset recovery in the EU*, 2016, https://www.europol.europa.eu/sites/default/files/documents/criminal_asset_recovery_in_the_eu_web_version_0.pdf.
- 4 Law no.06/L-087 on Extended Powers for Confiscation of Assets, Official Gazette of the Republic of Kosovo, 26 dhjetor 2018, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18337>.
- 5 *Reports of activities and recommendations of National Coordinator Against Economic Crime 2014–2021*, Kosovo Prosecutorial Council, shkurt 2022; intervistë me Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike në Prishtinë, 19 prill 2022.
- 6 Intervistë me Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike në Prishtinë, më 19 prill 2022.
- 7 Intervistë me një gjyqtar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, më 17 maj 2022.
- 8 TAIEX Case-based peer review mission on countering organized crime and corruption, dokument i pabotuar, korrik 2022.
- 9 *Reports of activities and recommendations of National Coordinator Against Economic Crime April–June 2016*, Kosovo Prosecutorial Council, korrik 2016.
- 10 Po aty.
- 11 Law no. 05/L-049 on the Management of Sequestered and Confiscated Assets, Official Gazette of the Republic of Kosovo, 14 prill 2016, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12360>.
- 12 Sasa Djordjevic, *Social reuse of confiscated assets*, GI-TOC, mars 2022, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2022/02/GMFA-Social-Reuse-of-Confiscated-Assets-Eng.pdf>.
- 13 Kosovo Ministry of Justice, *Publication of auctions*, <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=2,99>.
- 14 Government of the Republic of Kosovo, *Concept paper on the issue of unjustifiably acquired assets*, prill 2021, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/07/Concept-Paper-on-the-Issue-of-Unjustifiably-Acquired-Assets-converted.pdf>.
- 15 Government of the Republic of Kosovo, *Draft Law on the State Bureau for Verification and Confiscation of Unjustified Assets*, 29 dhjetor 2021, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Projektligji-per-Byrone-Shteterore-per-Verifikimin-dhe-Konfiskimin-e-Pas....pdf>.
- 16 Në projektligjin "Për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme", "personi fizik" është: personi i cili në organin shtetëror kryen punët zyrtare; personi i zgjedhur, i emëruar ose i caktuar në organin shtetëror, në organin e pushtetit lokal ose personi që përherë ose përkohësisht kryen detyrat zyrtare ose funksionet zyrtare në ato organe; personi në institucion, ndërmarrje ose në ndonjë subjekt tjetër, të cilit i janë besuar kryerja e autorizimeve publike, që vendos për të drejtat, obligimet ose interesat e personave fizikë ose juridikë ose për interesin publik; "person zyrtar" konsiderohet edhe personi të cilit i është besuar kryerja faktike e detyrave të caktuara zyrtare apo punëve; person ushtarak.
- 17 Government of the Republic of Kosovo, *Draft Law on the State Bureau for Verification and Confiscation of Unjustified Wealth*, 29 dhjetor 2021, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Projektligji-per-Byrone-Shteterore-per-Verifikimin-dhe-Konfiskimin-e-Pas....pdf>.
- 18 European Commission, *Kosovo Country Report 2021*, 19 tetor 2021, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en.
- 19 Kosovo Law Institute, *Confiscation of unjustified assets: the legal issues of the current Draft Law*, janar 2022, <https://kli-ks.org/en/>

- confiscation-of-unjustified-assets-the-legal-issues-of-the-current-draft-law.
- 20 Sefer Zogaj, *Konjufca do ta dërgojë në Komisionin e Venecias Projektligjin për Byronë*, KOHA, 24 shkurt 2022, <https://www.koha.net/arberi/312558/kurti-projektligji-per-byrone-shteterore-nuk-e-cenon-pavaresine-e-pushteteve>.
- 21 *Kosovo - Opinion on the Draft Law N°08/L-121 on the State Bureau for verification and confiscation of unjustified assets*, Venice Commission, Opinion No. 1083/2022, 20 qershor 2022, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2022\)014-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2022)014-e).
- 22 Ilirjana Hoti, *Kuvendi miraton në parim projektligjin për Byronë Shtetërore*, Kallxo, 14 korrik 2022, <https://kallxo.com/lajm/kuvendi-miraton-ne-parim-projektligjin-per-byrone-shteterore>.
- 23 Intervistë me Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike në Prishtinë, më 19 prill 2022.
- 24 Office of the Prime Minister, *84th meeting of the Government*, 22 qershor 2022, <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/mbledhja-e-84-te-e-qeverise>.
- 25 Ministry of Justice, *Concept paper for establishment of confiscation fund*, 22 dhjetor 2022, marr nga posta elektronike.
- 26 Po aty.
- 27 Sasa Djordjevic, *Social reuse of confiscated assets*, GI-TOC, mars 2022, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2022/02/GMFA-Social-Reuse-of-Confiscated-Assets-Eng.pdf>.

Luftëtarët e Ballkanit marrin armët në Ukrainë: rritet rreziku i krimit të organizuar.

Lufta në Ukrainë ka bërë që disa tregje kriminale (p.sh. trafikimi i heroinës) të zhvendosen, duke krijuar kështu mundësi të reja për krimin e organizuar, për shembull, për trafikimin e armëve, drogave sintetike dhe njerëzve. Në fakt, në një takim të mbajtur rishtas të Platformës Multidisiplinare Evropiane Kundër Kërcënimeve Kriminale (EMPACT), të organizuar nga EUROPOL-i, u dha paralajmërimi se lufta në Ukrainë mund të ndikojë te 10 tregje kriminale dhe te "rrjetet kriminale me rrezikshmëri të lartë".¹ Edhe pse i frikshëm, në këtë paralajmërim nuk përmendet rreziku i mundshëm ndaj sigurisë dhe qëndrueshmërisë politike në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BP), rrezik ky që mund të vijë si pasojë e kthimit të luftëtarëve ballkanas nga lufta në Ukrainë. Kërcënimi duket se nuk është trajtuar nga politikëbërësit evropianë ose nga qeveritë e gjashtë vendeve të BP-së,² qoftë në strategjitë kombëtare kundër terrorizmit, qoftë në vlerësimet e kërcënimit nga krimi i organizuar.³

Studimet e fundit kanë treguar se grupet e krimit të organizuar, duke përfshirë ato nga gjashtë vendet e BP-së, kanë mënyra të sofistikuar të veprimit dhe metoda të përparuar për rekrutimin. Për shembull, grupet nga gjashtë vendet e BP-së i kanë shtrirë rrjetet e tyre deri në Amerikën Latine, Afrikën e Jugut dhe Lindjen e Mesme.⁴ Në të kaluarën, të rinjtë që kishin përvojë në luftërat e ish-Jugosllavisë u bënë ushtarë këmbësorie (terreni) të grupeve kriminale, si në gjashtë vendet e BP-së, ashtu edhe jashtë rajonit. Ata ishin sipërmarrës në tregun e dhunës dhe kontraktoheshin si banditë, truproje, snajperë, vrasës me pagesë dhe ekspertë të komunikimit, si dhe për kontrabandimin e armëve dhe instalimin e lëndëve plasëse. Sot, grupet kriminale nga gjashtë vendet e BP-së, që veprojnë brenda dhe jashtë rajonit, kërkojnë individë me aftësi ushtarake, që dinë të përdorin armët e zjarrit dhe janë të aftësuar për t'u marrë me lëndët plasëse, me komunikim dhe kundërzbulimin, ose që janë të aftë të kontrabandojnë para fizike ose drogë dhe të neutralizojnë armiqtë duke përdorur metoda të sofistikuar vrasjeje.⁵ Disa prej organizatave kriminale më të fuqishme në rajon dhe në tregjet e tjera kryesore të krimit si Amerika Latine drejtohen nga individë me trajnim ushtarak ose kanë në përbërje të tyre individë të këtyllë.⁶ Grupet e krimit të

organizuar janë duke shtuar kërkesën për njerëz të tillë.⁷ Për këtë arsye, luftëtarët e huaj që kthehen në atdhe janë grupi i shënjestruar i grupeve të krimit. Edhe pse nuk ka prova të fuqishme që lënë të kuptohet se ka lidhje të drejtpërdrejta midis luftëtarëve të huaj të kthyer dhe grupeve të krimit të organizuar në gjashtë vendet e BP-së, ky rrezik duhet të shqyrtohet në mënyrë serioze, sidomos për shkak se rajoni ka treguar edhe më përpara që është edhe burim, edhe destinacion i luftëtarëve të huaj.

Në të kaluarën, gjashtë vendet e BP-së kanë qenë edhe destinacion, edhe burim i luftëtarëve të huaj. Besohet se numri i luftëtarëve të huaj që janë angazhuar në të gjitha palët gjatë luftërave në ish-Jugosllavi nuk kalonte 5% të numrit të përgjithshëm të të gjithë luftëtarëve.⁸ Megjithatë, gjatë luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, luftëtarët etnikë serbë mbështeteshin nga luftëtarë të huaj, të cilët njiheshin me nofken "kontraktniki" ose "luftëtarë me kontratë", që vinin kryesisht nga vendet ku mbizotëron feja ortodokse si Rusia, Greqia, Rumania, Ukraina dhe Polonia.⁹ Rreth 700 luftëtarë të huaj rus morën pjesë vetëm në luftën e Bosnjës dhe Hercegovinës, sipas qeverisë së Republikës Serbe.¹⁰ Ana boshnjake u mbështet nga disa qindra luftëtarë të huaj (përlllogaritjet variojnë nga 400 deri në 1 200), që vinin kryesisht nga Lindja e Mesme.¹¹ Gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-1999, pati qindra luftëtarë të huaj që iu bashkuan Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ata vinin kryesisht nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Suedia, Belgjika, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.¹² Edhe gjatë konfliktit në atë që më përpara njihet si ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë në vitin 2001, luftëtarët vinin nga Kosova për të mbështetur shqiptarët etnikë, ndërsa Forcat Maqedonase të Sigurisë u mbështetën me mjete fluturuese nga Ukraina deri në korrik të vitit 2001.¹³

Nga ana tjetër, gjashtë vendet e BP-së janë rajon që "eksportojnë" luftëtarë të huaj. Për shembull, llogaritjet se rreth 1 000 të rinj e të reja nga gjashtë vendet e BP-së iu bashkuan Shtetit Islamik në konfliktet në Siri dhe Irak, gjatë periudhës 2012-2016.¹⁴ Ka pasur shqetësime në lidhje me radikalizimin e atyre që janë kthyer.¹⁵

Më tej, ka shenja që qytetarët serbë, që morën anën e forcave proruse në Krimë në vitin 2014 kishin qenë pjesë e forcave paramilitare serbe.¹⁶ Për këto arsye, rreziku i luftëtarëve të huaj është se ata, jo vetëm që mund të kthehen me pikëpamje radikale ideologjike ose politike, por që, ish-kriminelët, mund t'i kthehen jetës së krimit pasi kanë fituar më shumë përvojë luftarake, pasi kanë krijuar rrjete të reja dhe kanë, në këtë mënyrë, qasje në ekonomitë e reja të paligjshme.¹⁷

Luftëtarët ballkanas në Ukrainë

Përlllogaritet se rreth 1 500 luftëtarë të huaj nga e gjithë bota iu bashkuan luftës gjatë pushtimit të parë të Ukrainës në vitin 2014 (deri në qershor të vitit 2016).¹⁸ Gjatë pushtimit të dytë të Ukrainës, në shkurt të vitit 2022, ka pasur rreth 36 000 (deri në korrik të vitit 2022).¹⁹ Kur krahasojmë shifrën e përafërt prej 40 000 luftëtarësh të huaj që iu bashkuan Shtetit Islamik gjatë ekzistencës së tij katërvjeçare në Siri dhe Irak (2014-2018), numri i luftëtarëve të huaj që u bënë pjesë e konfliktit të dytë (2022) në Ukrainë vetëm në muajt e parë të luftës është relativisht i lartë. Gjatë viteve të para (2022) të krizës në Ukrainë dhe rreth saj, mendohet se në luftimet e atjeshme kanë marrë pjesë rreth 300 individë nga gjashtë vendet e BP-së, ku disa janë bërë palë me separatistët prorusë, ndërsa të tjerët janë pjesë e batalioneve të vullnetarëve ukrainas.²⁰ Serbia ka qenë

një prej furnitoreve kryesore të luftëtarëve që luftojnë në krah të separatistëve prorusë: rreth 100 burra.²¹ Mendohet se disa prej tyre kanë kontribuar edhe në aneksimin e Krimesë në vitin 2014.²²

Nuk dihet ende numri i luftëtarëve të huaj nga gjashtë vendet e BP-së që kanë luftuar në Ukrainë që prej shkurtit të vitit 2022. Sipas mediave, shumë serbë etnikë nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë dalë vullnetarë për të mbështetur anën ruse,²³ madje edhe si pjesë e grupit "Wagner Group".²⁴

Nga ana tjetër, kur shpërtheu lufta në shkurt të vitit 2022, ministri i Punëve të Jashtme të Rusisë, Sergei Lavrov, deklaroi se mercenarët nga Shqipëria, Kosova dhe Bosnja dhe Hercegovina po rekrutoheshin dhe po transferoheshin për në Donbas të Ukrainës për të luftuar kundër rebelëve të mbështetur nga Moska.²⁵ Përfaqësues të Shqipërisë, Kosovës dhe Bosnjës dhe Hercegovinës kanë mohuar të ketë mercenarë nga vendet e tyre në Ukrainë, pretenduan se deklaratat e Rusisë, përkundrazi, janë "akuza false".²⁶

Profili dhe motivet e luftëtarëve të huaj

Në këtë studim të hollësishëm të luftëtarëve të huaj, që kanë pasur bindje ekstremiste ideologjike në konfliktin e vitit 2014 në Ukrainë, Kasper Rekaveku (Kacper Rekawek) vëren se luftëtarët e huaj perëndimorë në të



Disa mijëra burra nga Evropa Juglindore që kanë marrë armët për të luftuar në anën e Rusisë ose Ukrainës në luftën në Ukrainë.

Fotografia: Goran Uzunovic/EyeEM

dyja anët kanë prapavija të ndryshme ideologjike, duke përfshirë individë me bindje të djathta ekstreme, të majta ekstreme dhe nacional-komunistë kuq e kaf. Megjithatë, ata që shkuan në vitin 2022, duken më pak të radikalizuar dhe të politizuar.²⁷

Kur bëhet fjalë për historikun dhe motivimet e luftëtarëve nga gjashtë vendet e BP-së, të cilët po marrin pjesë në luftën e tanishme në Ukrainë, disa duket se janë motivuar nga bindje nacionaliste, ideologjike (si ekstremizmi i djathtë) ose fetare, ndërsa të tjerët janë thjesht mercenarë. Disa luftëtarë nga Kroacia pretendonin se po e mbështesnin Ukrainën, sepse “ishte ndër vendet e para që njohën sovranitetin e Kroacisë” në vitin 1991 dhe e kishte ndihmuar më vonë vendin “pas tërmeteve në Zagreb dhe Banovinë” në vitin 2020.²⁸ Disa luftëtarë serbë prorusë thuhet se motivohen nga solidariteti sllav,²⁹ mirënjohja për mbështetjen e Rusisë në konfliktet e mëparshme (për shembull, në rastin e krizës së Republikës Serbe),³⁰ hakmarrja kundër Perëndimit ose lidhjet me organizatat e së djathtës ekstreme si grupi serb “Patrullat e Popullit”.³¹ Edhe pse pjesëmarrësit janë kryesisht njerëz të rinj, të ndikuar nga propaganda dhe ideologjitë, disa janë veteranë të luftërave në ish-Jugosllavi.³² Ekziston rreziku që individët që marrin pjesë në njësitë me nivel të lartë

orientimi politik dhe ideologjik — nëse mbijetojnë — do të kthehen në atdhe me më shumë përvojë luftarake, por edhe me pikëpamje të radikalizuara.³³

Studimet për motivet e luftëtarëve të huaj nga gjashtë vendet e BP-së që u bënë pjesë e Shtetit Islamik dhe pushtimit të vitit 2014 të Ukrainës tregojnë edhe se disa luftëtarë të huaj me historik kriminal kanë marrë pjesë në konfliktet jashtë vendit me qëllim që të shmangnin ndjekjen penale në atdhe.³⁴

Efektiviteti i gjashtë vendeve të BP-së në drejtim të trajtimit të luftëtarëve që kthehen

Gjashtë vendet e BP-së kanë pasur njëfarë përvoje me trajtimin e luftëtarëve të huaj që u kthyen në vendin e tyre pasi kishin qenë pjesë e Shtetit Islamik në konfliktet në Siri dhe Irak. Që prej vitit 2020, pothuaj të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, që janë prekur nga kjo dukuri, janë duke zbatuar programe për rehabilitimin dhe riintegrimin e njerëzve të riatdhesuar nga zonat e konfliktit, shumica e të cilëve janë të mitur dhe gra që nuk kanë marrë pjesë në luftime, por edhe luftëtarë meshkuj të moshës madhore.³⁵ Kjo është tepër e rëndësishme, sepse, në disa raste, si në Kosovë, burrat dhe gratë e riatdhesuara janë futur në burg në bazë të



Trajnim i oficerëve të Forcave të Armatosura të Ukrainës.

Fotografia: Ministria e Mbrojtjes e Ukrainës

akuzave për terrorizëm.³⁶ Këto programe përfshijnë këshillim psikologjik dhe fetar për të burgosurit, mbështetje sociale për familjet dhe hartim të programeve të reja të punësimit për ata që bëhen përsëri pjesë e shoqërisë.³⁷

Duhet shënuar që të gjashta vendet e BP-së i kanë miratuar rezolutat 2178 (2014) dhe 2396 (2017) të Këshillimit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për të parandaluar rekrutimin dhe lëvizjen e luftëtarëve të huaj terroristë dhe për të siguruar që shtetet të hartojnë strategji për ndjekjen penale, rehabilitimin dhe riintegrimin e luftëtarëve që kthehen.³⁸ Megjithatë, shumica e gjashtë vendeve të BP-së nuk e kanë nënshkruar "Konventën ndërkombëtare kundër rekrutimit, përdorimit, financimit dhe trajnimit të mercenarëve", e cila hyri në fuqi në vitin 2001.³⁹ Rreziku që vjen nga mosnënshkrimi i kësaj konvente është që vendet e rajonit mund t'i lejojnë vetes të përdorin, financojnë dhe trajnojnë mercenarë, të cilët, më pas, mund të merren në punë nga grupet ndërkombëtare të krimit të organizuar për të kryer vepra penale dhe për të destabilizuar shtetin e së drejtës.

Gjashtë vendet e BP-së i kanë ndryshuar ligjet në mënyrë të tillë që të kriminalizojnë të gjitha format e pjesëmarrjes në konflikte të armatosura jashtë vendit,⁴⁰ ku Serbia është

i vetmi vend në rajon që nuk e ka kriminalizuar haptas dhe qartë mbështetjen e publikut ndaj udhëtimit drejt zonave të konfliktit. Veprat penale për luftëtarët e huaj ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, por legjislacioni i Shqipërisë dhe Kosovës parashikon dënimet më të ashpra: midis 5 deri në 15 vjet burg.⁴¹

Çështja e kthimit të luftëtarëve të huaj — që mori vëmendje të konsiderueshme kur qindra njerëz nga rajoni u bënë pjesë e Shtetit Islamik — duhet të shqyrtohet më nga afër. Mund të thuhet se rreziku i radikalizimit të burrave që luftojnë në Ukrainë është më i ulët sesa ai i atyre që luftuan në Lindjen e Mesme. Në fakt, deri më tani, lidhjet midis krimit të organizuar dhe luftëtarëve të huaj në Ukrainë nga Ballkani duken të dobëta. Pavarësisht kësaj, kthimi në atdhe i të rinjve të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, që kanë luftuar në Ukrainë, mund të fryjë radhët e paramilitarëve, të rrisë tensionet ndëretnike dhe të shtojë numrin e ushtarëve këmbësorë që mund të rekrutohen nga grupet kriminale, sikurse është vënë re pas luftërave të viteve 1990 në ish-Jugosllavi. Prandaj, strategjitë për vlerësimin e rrezikut të luftimit të krimit të organizuar dhe terrorizmit duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të mundësojnë monitorimin dhe analizimin e rreziqeve të mundshme që paraqet kthimi i luftëtarëve të huaj.

Shënime

- 1 "Rrjetet kriminale me rrezikshmëri të lartë" nuk përkufizohen nga EMPACT-i, por, me sa duket, kanë të bëjnë me ato rrjete që përdorin "korrupsionin, aktet e dhunës, armët e zjarrit dhe pastrimin e parave nëpërmjet sistemeve financiare paralele të botës së krimit". Council of the EU, *Fight against organised crime: Council sets out 10 priorities for the next 4 years*, 26 maj 2021, <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2021/05/26/fight-against-organised-crime-council-sets-out-10-priorities-for-the-next-4-years>.
- 2 *Cooperation on the fight against organised crime in the Western Balkans (P9_TA(2021)0506)*, European Parliament resolution, 15 dhjetor 2021, https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2021-0506_EN.html.
- 3 Në strategjinë e BE-së përmendet bashkëpunimi për luftën kundër terrorizmit, por nuk trajtohet rreziku që vjen nga luftëtarët e huaj të kthyer. *Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions on the EU Strategy to tackle Organised Crime 2021–2025*, COM/2021/170 final, European Commission, 14 prill 2021, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52021DC0170&qid=1632306192409>.
- 4 EUROPOL, *Joint investigation team leads to dismantling of one of Europe's most active Albanian-speaking networks trafficking cocaine into Europe*, 17 shtator 2020, <https://www.europol.europa.eu/media-press/newsroom/news/joint-investigation-team-leads-to-dismantling-of-one-of-europe%E2%80%99s-most-active-albanian-speaking-networks-trafficking-cocaine>.
- 5 Walter Kemp, *Transnational tentacles: Global hotspots of Western Balkan organised crime*, GI-TOC, korrik 2020, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/07/Transnational-Tentacles-Global-Hotspots-of-Balkan-Organized-Crime-ENGLISH_MRES.pdf.
- 6 Carter Smith, *Gangs and the military note 2: Military-trained gang members as criminal insurgents*, Small Wars Journal, 31 maj 2018, <https://smallwarsjournal.com/jrnl/art/gangs-and-military-note-2-military-trained-gang-members-criminal-insurgents>.
- 7 Po aty.
- 8 Evan F Kohlmann, *Al-Qaida's Jihad in Europe: The Afghan-Bosnian Network*, Oxford/New York: Berg Publishers, 2004, 18–19.
- 9 Arielli Nir, *In search of meaning: Foreign volunteers in the Croatian armed forces, 1991–95*, Contemporary European History 21, 1, 1–17; Wspomnienia byłego najemnika, Polaka – uczestnika wojny w Bośni i Hercegowinie / Johnny B., "Kurier WNET" 70/2020, Radia Wnet, 1 maj 2020, <https://wnet.fm/kurier/wspomnienia-bylego-najemnika-polaka-uczestnika-wojny-w-bosni-i-hercegowinie-johny-b-kurier-wnet-70-2020>.
- 10 Meliha Kešmer, *Od Bosne do Ukrajine ista lica među ruskim dobrovoljcima*, Radio Slobodna Evropa, 10 mars 2022, <https://www.slobodnaevropa.org/a/rusi-placenic-bih-rat-visegrad-ukrajina/31746321.html>.
- 11 Vlado Azinović and Merdijana Sadović, *Otkuda strani mudžahedini u BiH?*, Radio Slobodna Evropa, 20 prill 2008, <https://www.slobodnaevropa.org/a/1107532.html>; Edin Subašić, "Džihad" u BiH (1): Mudžahedini su podvala Zapada, Al Jazeera, 3

- mund 2019, <https://balkans.aljazeera.net/opinions/2019/5/3/dzihad-u-bih-1-mudzahedini-su-podvala-zapada>.
- 12 Adriatik Kelmendi, *Kosovars refute Islamic terror claims*, Institute for War and Peace Reporting, 11 nëntor 2001, <https://iwpr.net/global-voices/kosovars-refute-islamic-terror-claims>.
 - 13 Taraz Kuzio, *Ukraine forges military alliance with Macedonia*, The Jamestown Foundation, 7, 10, <https://jamestown.org/program/ukraine-forges-military-alliance-with-macedonia/#.VUfxKvmqqko>.
 - 14 Vlado Azinović, ed, *Between salvation and terror: Radicalization and the foreign fighter phenomenon in the Western Balkans*, School of Political Science and Atlantic Initiative, 2017, https://atlanticinitiative.org/wp-content/uploads/2017/05/images_BetweenSalvationAndTerror_BetweenSalvationAndTerror.pdf.
 - 15 Leonie Vrugtman, *Future challenges of violent extremism in the Western Balkans*, Institute for Democracy and Mediation, shkurt 2019, <https://idmalbania.org/future-challenges-of-violent-extremism-in-the-western-balkans-february-2019>.
 - 16 Aleksandar Vasovic, *Serbian paramilitaries join pro-Russian forces in Crimea*, Reuters, 14 mars 2014, <https://www.reuters.com/article/us-crimea-volunteers-idUSBREA2D0C020140314>.
 - 17 Tanya Mehra dhe Abigail Thorley, *Foreign fighters, foreign volunteers and mercenaries in the Ukrainian armed conflict*, International Centre for Counter-Terrorism, 11 korrik 2022, <https://icct.nl/publication/foreign-fighters-volunteers-mercenaries-in-ukraine>.
 - 18 Asya Metodieva, *Balkan fighters in Eastern Ukraine: Why are they there?*, Riddle, 29 prill 2019, <https://ridl.io/balkan-fighters-in-eastern-ukraine-why-are-they-there/#:~:text=About%20300%20Balkan%20fighters%20have,if%20it%20was%20their%20own>.
 - 19 Tanya Mehra dhe Abigail Thorley, *Foreign fighters, foreign volunteers and mercenaries in the Ukrainian armed conflict*, International Centre for Counter-Terrorism, 11 korrik 2022, <https://icct.nl/publication/foreign-fighters-volunteers-mercenaries-in-ukraine>.
 - 20 Vuk Velebit, *Serb fighters in Ukraine continue to worry the West*, European Western Balkans, 19 dhjetor 2017, <https://europeanwesternbalkans.com/2017/12/29/serb-fighters-ukraine-continue-worry-west>.
 - 21 Po aty.
 - 22 Jelena Beslin dhe Marija Ignjatijevic, *Balkan foreign fighters: From Syria to Ukraine*, Brief issue 20, European Union Institute for Security Studies, qershor 2017, <https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief%2020%20Balkan%20foreign%20fighters.pdf>.
 - 23 Nermina Kulogljia dhe Azra Husaric Omerovic, *Serb Volunteers Answer Call to Fight in Ukraine*, BalkanInsight, 8 mars 2022, <https://balkaninsight.com/2022/03/08/serb-volunteers-answer-call-to-fight-in-ukraine>.
 - 24 Maja Zivanovic, *Donbass brothers: How Serbian fighters were deployed in Ukraine*, BalkanInsight, 13 dhjetor 2018, <https://balkaninsight.com/2018/12/13/donbass-brothers-how-serbian-fighters-were-deployed-in-ukraine-12-12-2018>.
 - 25 Alice Taylor, *Moscow claims mercenaries from Western Balkans fight in Ukraine*, Euractiv, 22 shkurt 2022, https://www.euractiv.com/section/politics/short_news/moscow-claims-mercenaries-from-western-balkans-fight-in-ukraine.
 - 26 Talha Ozturk, *Western Balkan countries rebuff Russian claims they sent mercenaries to Ukraine*, Anadolu Agency, 21 shkurt 2022, <https://www.aa.com.tr/en/politics/western-balkan-countries-rebuff-russian-claims-they-sent-mercenaries-to-ukraine/2508795>.
 - 27 Kacper Rekawek, *Western extremists and the Russian invasion of Ukraine in 2022: All talk, but not a lot of walk*, Counter Extremism Project, 2022, https://www.counterextremism.com/sites/default/files/2022-05/Western%20Extremists%20and%20the%20Russian%20Invasion%20of%20Ukraine%20in%202022_May%202022.pdf.
 - 28 Matea Grgurinovic, *Croatian volunteer fighters head for Ukrainian frontline*, BalkanInsight, 28 shkurt 2022, <https://balkaninsight.com/2022/02/28/croatian-volunteer-fighters-head-for-ukrainian-frontline>.
 - 29 Meliha Kešmer, *Od Bosne do Ukrajine ista lica među ruskim dobrovoljcima*, Radio Slobodna Evropa, 10 mars 2022, <https://www.slobodnaevropa.org/a/rusi-placenic-bih-rat-visegrad-ukrajina/31746321.html>.
 - 30 Marko Didić, *Dobrovoljci iz Republike Srpske vraćaju ratni dug 'braći Rusima'? Evo gdje ova teorija vuče korijene, riječi umirovljenog generala otkrivaju sve: 'Dok su Srbi i Rusi zajedno, Allahov put neće biti uspostavljen'*, Slobodna Dalmacija, 24 maj 2022, <https://slobodnadalmacija.hr/vijesti/regija/dobrovoljci-iz-republike-srpske-vracaju-ratni-dug-braci-rusima-evo-gdje-ova-teorija-vuce-korijene-rijeci-umirovljenog-general-a-otkrivaju-sve-dok-su-srbi-i-rusi-zajedno-allahov-put-uce-bit-i-uspostavljen-1195334>.
 - 31 Nermina Kulogljia dhe Azra Husaric Omerovic, *Serb volunteers answer call to fight in Ukraine*, BalkanInsight, 8 mars 2022, <https://balkaninsight.com/2022/03/08/serb-volunteers-answer-call-to-fight-in-ukraine>.
 - 32 Po aty.
 - 33 Snezana Bjelotomic, *Serbian and Russian ultra-right joining forces*, Serbian Monitor, 22 korrik 2022, <https://www.serbianmonitor.com/en/serbian-and-russian-ultra-right-joining-forces>.
 - 34 Jelena Beslin dhe Marija Ignjatijevic, *Balkan foreign fighters: From Syria to Ukraine*, Brief issue 20, European Union Institute for Security Studies, qershor 2017, <https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief%2020%20Balkan%20foreign%20fighters.pdf>.
 - 35 Fjori Sinoruka, Xhorxhina Bami and Sinisa Jakov Marusic, *Welcome Home? ISIS returnees test Balkan countries' ability to reintegrate*, BalkanInsight, 20 gusht 2021, <https://balkaninsight.com/2021/08/20/welcome-home-isis-returnees-test-balkan-countries-ability-to-reintegrate>.
 - 36 Po aty.
 - 37 Adrian Shtuni, *Rehabilitation and reintegration path of Kosovar minors and women repatriated from Syria*, International Republican Institute, 14 shtator 2021, <https://www.iri.org/resources/new-report-supports-rehabilitation-of-kosovo-youth-and-women-with-connection-to-violent-extremism>.
 - 38 Naureen C Fink dhe Colin P Clarke, *Foreign fighters are heading to Ukraine. That's a moment for worry*, Politico, 10 mars 2022, www.politico.com/news/magazine/2022/03/10/foreign-fighters-are-heading-to-ukraine-thats-a-moment-for-worry-00016084.
 - 39 United Nations, *List of signatories to the International Convention against the Recruitment, Use, Financing and Training of Mercenaries*, 11 dhjetor 2022, https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=IND&mtdsg_no=XVIII-6&chapter=18&clang=en.
 - 40 Luka Glusac, *Criminalization as anxious and ineffective response to foreign fighters phenomenon in the Western Balkans*, *Journal of Regional Security*, 15, 1, 39–74.
 - 41 Po aty.

Dokumentet ballkanike të rreme ose të siguruara në mënyrë të paligjshme po ua lehtësojnë udhëtimin kriminelëve kudo në botë.

Zyrtarët policorë që hetojnë grupet e krimit të organizuar që veprojnë në Ballkanin Perëndimor ose që vijnë prej tij kanë vënë në dukje herë pas here diçka të ngjashme: lehtësinë me të cilën shumë kriminelë udhëtojnë nëpër botë duke përdorur pasaporta false ose dokumente emigrimi të siguruara në mënyrë të paligjshme, të lëshuara nga vendet e rajonit. Nga vetë natyra e tij, krimi i organizuar ndërkombëtar është krim që kapërcen kufijtë. Disa prej këtyre veprimtarive të paligjshme kryhen në internet, duke përdorur hapësirën kibernetike, rrjetet e komunikimit të koduar ose kriptovalutat. Por, për të kryer shumë veprimtari që kanë të bëjnë me krime si trafikimi, kriminelëve u duhet të kalojnë fizikisht kufijtë e shteteve pa u zbuluar. Prandaj, u duhen dokumente të falsifikuara.

Sipas disa hetuesve me të cilët biseduam për këtë artikull, shpreshtia e problemit në Ballkanin Perëndimor lë të kuptohet se ka grupe që përgatisin dokumente të falsifikuara si shërbim kriminal. Kriminelët kombinonë informacionet e vërteta të identifikimit me ato të fabrikuara për të krijuar të ashtuquajturat identitete sintetike ose të rreme, të cilat mund t'i përdorin kur udhëtojnë, që të mos bien në sy ose për të kaluar nëpër procesin e verifikimit të identitetit kur kanë të bëjnë me ndonjë institucion financiar. Megjithatë, me përdorimin e dokumenteve biometrike, prodhimi i dokumenteve false nuk është aq i shpeshtë sa ishte dikur. Në vend të kësaj, kriminelët priren të përdorin dokumente të vërteta ose i modifikojnë ato për të kryer veprimtari të paligjshme.¹

Ka dy mënyra me të cilat kriminelët i sigurojnë këto dokumente. Ose modifikojnë fizikisht pasaportën e vlershme që është vjedhur ose blerë në tregun e zi, duke ndryshuar foton ose të dhënat biografike, ose blejnë në mënyrë të paligjshme një pasaportë të vlefshme me emrin e tyre ose me një nofkë, pasi i kanë dhënë rryshfet një zyrtari të korruptuar. Duke vepruar kështu, kriminelët që është shpallur në kërkim jashtë vendit mund të ndryshojë identitetin dhe të lëvizë lirshëm, pa u penguar, si qytetar i një vendi të Ballkanit Perëndimor. Nga ana tjetër, kriminelët nga Ballkani Perëndimor mund të

sigurojnë dokumente udhëtimi nga një vend i BE-së dhe të lëvizin lirshëm brenda zonës "Shengen". Gjithashtu, ndonjëherë kriminelët nga rajoni kanë disa identitete, me qëllim shmangien e zbulimit. Identitete të tilla u mundësojnë atyre të kryejnë veprat e mashtrimit.

Identifikimi i këtyre njerëzve bëhet më i vështirë, sepse zyrtarët e zbatimit të ligjit në rajonin e Ballkanit Perëndimor nuk shkëmbejnë mjaftueshëm të dhëna midis tyre. Ekziston tendenca për të punuar nëpërmjet INTERPOL-it dhe jo drejtpërdrejtë.²

Kohët e fundit, ka pasur një numër rastesh nga të cilat u vu re se zyrtarët e korruptuar u kanë lëshuar, në mënyrë të paligjshme, pasaporta disa personave me qëllim që këta të shmangin ndjekjen penale në vendet e tjera. Problemi më i madh i identifikuar ka qenë në Maqedoninë e Veriut, në rastin "Dvojnik" të bërë publik. Në prill të vitit 2021, partia opozitare e Maqedonisë së Veriut, VMRO-DPMNE, pretendoi se të paktën 215 pasaporta u ishin lëshuar nga Ministria e Brendshme kriminelëve të huaj dhe individëve me rrezikshmëri të lartë, duke përfshirë edhe disa prej shefave kryesorë të grupeve kriminale.³ Ai që tregon se sa i thellë ishte skandali është rasti i lordit turk të krimit, Sedat Pekerit, i cili është dënuar më përpara për veprimtari kriminale. Ai kishte marrë një pasaportë të Maqedonisë së Veriut duke përdorur identitet të rremë.⁴ Fotografitë e postuara në rrjetet sociale tregonin një polic jashtë detyrës që vepronte si truprojtë i Pekerit ndërkohë që ky ecte në rrugët e Shkupit.⁵

Një tjetër kriminel i madh i identifikuar në këtë skandal ishte Jovan Vukotiči.⁶ Vukotiči pretendohet se ka qenë drejtuesi i klanit malazez "Shkaljari", njëri nga dy grupet më të mëdha të trafikimit të drogës në Ballkanin Perëndimor. Ai ishte shpallur në kërkim në Greqi për shkak të dyshimeve për trafikim të drogës dhe për krime të tjera të rënda. Ai u arrestua në Turqi në vitin 2018 dhe u dërgua në Serbi, ku bëri 15 muaj burg për përdorim të një pasaporte të falsifikuar, dhe pastaj u ekstradua në Mal të Zi në shkurt të vitit 2020. Ai ishte



FIGURA 1 Renditja krahasuese e pasaportave të gjashtë vendeve të BP-së.

Burimi: *Passport Index*, <https://www.passportindex.org>

shpallur në kërkim në Mal të Zi për vrasje të mbetur në tentativë, por prokuroria i ndërpreu procedurat kundër tij në korrik të vitit 2020. Pasi doli nga burgu në janar të vitit 2022, prokuroria e akuzoi se kishte shmangur tatimin mbi 22 800 euro. Pas disa muajsh, ai u vra në Stamboll.⁷ Sipas të dhënave nga policia turke, Vukotići kishte hyrë në Turqi në mënyrë të paligjshme duke përdorur një pasaportë të Maqedonisë së Veriut, të cilën e kishte siguruar në Kosovë duke përdorur emrin e rremë Predrag Popović.⁸

Në nëntor të vitit 2022, media zbuloi se biznesmeni dhe politikani ukrainas, Oleksandër Onishçenko (Oleksandr Onyshchenko) kishte siguruar pasaportën e tij të tretë nga Maqedonia e Veriut, në rrethana të dyshimta.⁹

Onishçenkoja ka qenë në listën e sanksioneve të SHBA-së që prej janarit të vitit 2021, sepse ishte “anëtar i rrjetit rus që u përzje me zgjedhjet presidenciale në SHBA”. Krahas kësaj, Onishçenkoja është person i shpallur në kërkim në Ukrainë: ai u arratis nga vendi në vitin 2016 pasi komisioni kundër korrupsionit nisi një hetim kundër tij për pastrim parash dhe për korrupsion të ndërlidhur me shitjen e gazit.¹⁰ Vetëm pesë muaj pasi mori shtetësinë nga Maqedonia e Veriut në maj të vitit 2022, Onishçenkoja mori pjesë në një garë me kuaj në San-Trope të Francës si përfaqësues i vendit të tij të ri.¹¹ Megjithatë, në datën 3 dhjetor 2022, autoritetet e Maqedonisë së Veriut e tërhoqën shtetësinë që i kishin dhënë të arratisurit ukrainas dhe ia anuluan pasaportën.¹²

Shkalla e praktikës së shitjes së pasaportave individëve të dyshimtë ka ngritur dyshime si në Maqedoninë e Veriut, ashtu edhe në shtetet mike të saj.

Megjithatë, Maqedonia e Veriut nuk është i vetmi shtet në Evropën Juglindore që ka probleme me pasaportat e rreme. Në vitin 2022, policia greke, me mbështetjen e EUROPOL-it, goditi një rrjet kriminal që merrej me prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve të falsifikuara në Greqi. EUROPOL-i i kishte nisur hetimet në mars të vitit 2021 dhe kishte zbuluar se banda kishte ngritur një pikë printimi në Athinë për falsifikimin e dokumenteve të ndryshme të udhëtimit. Në qershor të vitit 2022, autoritetet arrestuan tetë persona që dyshoheshin se u kishin dhënë dokumente udhëtimi kontrabandistëve të emigrantëve, duke lehtësuar kështu lëvizjen e paligjshme të njerëzve nga Egjipti drejt BE-së. U sekuestruan 362 dokumente të falsifikuara.¹³

Në fillim të nëntorit të vitit 2022, oficerët e policisë serbe nga Departamenti për Luftimin e Krimit të Organizuar Financiar, në bashkëpunim me personelin e Shërbimit për Luftimin e Terrorizmit dhe Ekstremizmit, arrestuan tre kriminelë nga Novi Pazari në bazë të dyshimeve se kishin krijuar dhe shitur dokumente të falsifikuara. Në reportazhet e medieve serbe pretendohet se grupi kriminal kishte shitur dokumente në tregun e zi për 500 euro copa.¹⁴

Në Shqipëri, nga viti 2016 janë arrestuar mbi 1 200 persona për mashtrim me viza dhe pasaporta. Në vitin 2021 u krye një hetim i madh gjatë të cilit u zbulua se kërkesa më e madhe për pasaporta false vinte nga qytetarët aziatikë që kërkonin të lidhnin kontakte me grupet kriminale në Shqipëri, si dhe nga njerëz që kërkonin dokumente udhëtimi për të shkuar në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Shtetet e Bashkuara.¹⁵

Shqiptarët janë viktimat më të zakonshme të trafikimit në Mbretërinë e Bashkuar: disa prej tyre kanë dokumente të falsifikuara. Në vend që të kërkojnë azil, disa emigrantë zgjedhin të zhduken dhe të punojnë në të zehtë në Mbretërinë e Bashkuar, dhe pastaj kthehen në atdhe. Çmimi i një pasaporte të rreme ose i një dokumenti të falsifikuar udhëtimi për në Mbretërinë e Bashkuar varion nga 5 000 euro në 10 000 euro.¹⁶

Ka pretendime se kriminelët e Ballkanit blejnë pasaporta kroate për të lehtësuar hyrjen në BE.¹⁷ Pasaportat kroate mundësojnë hyrjen e lehtë në BE, sidomos tani që Kroacia është pjesë e zonës “Shengen”. Në të kaluarën, raportohet se janë arrestuar disa figura kryesore serbe të krimit, me pasaporta kroate false, duke përfshirë Sinisa Petriçin, Vladimir Milisavljeviçin, i njohur me nofkën “Budallai” dhe shefin e tij, Luka Bojoviç, i njohur me nofkën “Furrxhiu”.¹⁸ Kohëve të fundit, ka pasur një numër rastesh ku dokumentet kroate janë siguruar në mënyrë të paligjshme,¹⁹ duke përfshirë rastin me profil të lartë të Filip Koraçit (i cili raportohet se ka lidhje me aktorët kryesorë të krimit në Ballkan), i cili u dënua me një vit heqje lirie në qershor të vitit 2022 për shkak të falsifikimit të një pasaporte kroate.²⁰

Byroja Kroate për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar kreu një hetim nga i cili zbuloi se midis vitit 2017 dhe nëntorit të vitit 2019, ishin prodhuar dhe shitur të paktën 42 letërnjoftime kroate dhe mbi 40 pasaporta të mbështetura në dokumente serbe false. Çmimi fillonte nga 3 500 euro për dokument.²¹ Si pasojë e hetimit u arrestuan 19 persona.²²

Më tej, është raportuar se qindra persona, duke përfshirë kriminelë, kanë arritur të sigurojnë dokumente identifikimi dhe dokumente udhëtimi boshnjake të falsifikuara. Kjo çoi në bastisje dhe arrestime, nga ana e policisë kroate, në kuadër të Agjencisë Shtetërore të Hetimeve dhe Mbrojtjes.²³ Për shembull, kriminelët ballkanas nga klani famëkeq i Kavaçit, Almir Jahoviç dhe Radoje Zhivkoviç, u arrestuan në Turqi për shkak të dyshimeve për vrasje. Ata u kapën me pasaporta false të lëshuara në Bosnjë dhe Hercegovinë.²⁴

Një tjetër faktor që ndikon në marrjen e paligjshme të identitetit boshnjak është se, ndryshe nga vendet fqinje, në Bosnjë dhe Hercegovinë dënimet me më pak se një vit burg mund të shmangen duke paguar gjobë.²⁵ Sipas hulumtimeve nga Qendra për Gazetari Investigative,



Një zyrtar dogane verifikon një pasaportë në pikën e kalimit kufitar Serbi-Hungari në Horgos, dhjetor 2009. Duke filluar nga 19 dhjetori, BE-ja u ka mundësuar Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi lëvizje të lirë pa vizë brenda bllokut të 27 shteteve.

Fotografia: Reuters/Djordje Kojadinovic

midis viteve 2017-2019, gjykatat në Bosnjë dhe Hercegovinë u kanë lejuar të dënuarve të blejnë gjithsej 263 vjet heqje lirie për rreth 4,6 milionë euro.²⁶ Prandaj, kriminelët nga Serbia dhe Kroacia përdorin shtetësinë boshnjake për t'i transferuar dënimet e tyre në Bosnjë, me qëllim që të mos vuajnë dënimin në burg.²⁷

Bosnja dhe Hercegovina po përdoret edhe si pikë tranziti për njerëzit me dokumente të falsifikuara, të cilët përipiqen të hyjnë në BE. Sipas policisë kufitare boshnjake, qytetarët etnikë çeçenë të Rusisë janë përpjekur së fundmi të hyjnë në Bosnjë dhe Hercegovinë nëpërmjet aeroporteve të Sarajevës dhe Tuzlës duke përdorur regjimin e lëvizjes pa viza.²⁸ Ata mbanin lejeqëndrime të falsifikuara nga disa vende të BE-së dhe udhëtonin me qëllim që të hynin në BE.

Rreziqet për sigurinë, që paraqesin pasaportat false të lëshuara nga vendet e Evropës Juglindore, duhet të shqyrtohen me më shumë vëmendje dhe kontrollet duhet të bëhen më të rrepta. Dokumentet e falsifikuara të udhëtimit ose dokumentet e vërteta, por që janë siguruar në rrugë të dyshimta, përbëjnë një prej

metodave kryesore të mundësimit të krimit të organizuar. Ato u mundësojnë kriminelëve ose personave të ekspozuar politikisht që të lëvizin pa u zbuluar. Më tej, këto dokumente bëhen treg kriminal në vetvete: dokumentet e falsifikuara përdoren dhe shiten në masë të madhe midis anëtarëve të grupeve të krimit të organizuar. Kjo praktikë dëmton edhe emrin e vendeve ku prodhohen ose lëshohen këto dokumente.

Autoritetet kombëtare në rajon duhet të hartojnë strategji më të mira për vlerësimin e kontrollit dhe të punojnë me partnerët në rajon (si BE-ja dhe Turqia) për të monitoruar situatën. Gjithashtu, ekziston një nevojë e madhe për shkëmbimin e informacioneve në lidhje me dokumentet e rreme të udhëtimit dhe për nofkat. Kjo është temë të cilës duhet t'i jepet përparësi në kuadër të bashkëpunimit rajonal, për shembull, nëpërmjet Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC) dhe Nismës Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI), të cilat kanë bërë thirrje për bashkëpunim më të ngushtë në fushën e zbatimit të ligjit në kuadër të sigurisë së dokumenteve të udhëtimit.

Shënime

- 1 INTERPOL, *Identity and travel document fraud*, <https://www.interpol.int/en/Crimes/Counterfeit-currency-and-security-documents/Identity-and-travel-document-fraud>.
- 2 Intervistë me një polic nga Maqedonia e Veriut, 22 nëntor 2022.
- 3 Sinisa Jakov Marusic, *North Macedonia claims to bust police gang forging passports*, *BalkanInsight*, 7 prill 2021, <https://balkaninsight.com/2021/04/07/north-macedonia-claims-to-bust-police-gang-forging-passports>.
- 4 Observatory of Illicit Economies in South-Eastern Europe, *Passports and protection: the Macedonian connection of a Turkish crime boss*, *Risk Bulletin – Issue 8, GI-TOC*, korrik-gusht 2021, <https://globalinitiative.net/analysis/seeobs-risk-bulletin-8>.
- 5 Po aty.
- 6 Sinisa Jakov Marusic, *North Macedonia arrests police in crackdown on passport-forgers*, *BalkanInsight*, 6 prill 2021, <https://balkaninsight.com/2021/04/06/north-macedonia-arrests-police-in-crackdown-on-passport-forgers>.
- 7 Jelena Radivojević, *Ubijen vođa skaljarskog klana Jovan Vukotić*, *KRIK*, 8 shtator 2022, <https://www.krik.rs/ubijen-vodja-skaljarskog-klana-jovan-vukotic>.
- 8 *Jovan Vukotić lažni pasoš nabavio na Kosovu*, *RTCG*, 8 dhjetor 2022, https://rtcg.me/vijesti/crna_hronika/389458/jovan-vukotic-lazni-pasos-nabavio-na-kosovu.html?fbclid=IwAR1DB1gdjO-luyBfE91PcU6LM9wBXdh_cTHDy2fmFGqsie85xh8EiygBsAg.
- 9 Frosina Dimeska, *Fugitive Ukraine politician under US sanctions wins North Macedonia citizenship*, *BalkanInsight*, 11 nëntor 2022, <https://balkaninsight.com/2022/11/11/fugitive-ukraine-politician-under-us-sanctions-wins-north-macedonia-citizenship>.
- 10 Anna Kholodnova, *Fugitive ex-lawmaker Oleksandr Onyshchenko received citizenship of North Macedonia date*, *Babel*, 11 nëntor 2022, <https://babel.ua/en/news/86912-media-fugitive-ex-lawmaker-oleksandr-onyshchenko-received-citizenship-of-north-macedonia>.
- 11 Po aty.
- 12 European Observatory of Crimes and Security, *North Macedonia scraps fugitive Ukrainian citizenship date*, 7 dhjetor 2022, <https://www.eu-ocs.com/north-macedonia-scraps-fugitive-ukrainian-citizenship>.
- 13 *Balkan police arrest 13 for gang-related identity theft*, *Reuters*, 20 qershor 2016, <https://www.reuters.com/article/us-bosnia-crime-arrests-idUSKCN0Z61PO>.
- 14 *Falsifikovali dokumenta: Uhapšen trojac iz Novog Pazara*, *Nportal*, 1 nëntor 2022, <https://www.nportal.rs/vest/36979/vesti/crna-hronika/novi-pazar-lazna-dokumenta-falsifikovanje>.
- 15 Nora Muci, *Over 1,200 arrested in a 5-year timespan for visa and passport fraud*, *Euronews*, 18 shkurt 2022, <https://euronews.al/en/250-arrested-in-a-year-for-visa-and-passport-fraud>.
- 16 Valbona Bezati, *London calling: Albanians count cost of UK illegality*, *BalkanInsight*, 29 tetor 2020, <https://balkaninsight.com/2020/10/29/london-calling-albanians-count-cost-of-uk-illegality>.
- 17 *Srpskoj mafiji naše lažne putovnice omogućuju kretanje po Europi, praktične zbog sličnih imena*, *Večernji list*, 4 korrik 2021, <https://www.vecernji.hr/vijesti/srpskoj-mafiji-nase-lazne-putovnice-omogucuju-kretanje-po-europi-prakticne-zbog-slicnih-imena-1505287>.
- 18 OCCRP, *Six arrested in croatia for falsifying passports for gangsters*, 26 mars 2012, <https://www.occrp.org/en/daily/1453-six-arrested-in-croatia-for-falsifying-passports-for-gangsters>.
- 19 Dušan Miljuš, *Hrvatsku putovnicu podigao i crnogorski narkobos, objavujemo snimke razgovora i SMS-ove mafijaša*, *Jutarnji list*, <https://www.jutarnji.hr/vijesti/crna-kronika/hrvatsku-putovnicu->

- podigao-i-crnogorski-narkobos-objavljujemo-snimke-razgovora-i-sms-ove-mafijasa-15036566.
- 20 Marin Dešković, *Šef Zemunskog klana na sudu u Zagrebu: 'Da, koristio sam krivotvorenu putovnicu RH. Prijetilo mi je ubojstvo'*, Jutarnji list, 7 qershor 2022, <https://www.jutarnji.hr/vijesti/crnakronika/sef-zemunskog-klana-na-sudu-u-zagrebu-da-koristio-sam-krivotvorenu-putovnicu-rh-prijetilo-mi-je-ubojstvo-15207431>.
- 21 *Court remands thought to be involved in large-scale fake passports scheme*, HINA/N1, 29 nëntor 2019, <https://hr.n1info.com/english/news/a463992-court-remands-21-thought-to-be-involved-in-large-scale-fake-passports-scheme>.
- 22 Po aty.
- 23 State Investigation and Prosecution Agency, *SIPA apprehended three individuals for forging of documents in operation codenamed 'Art'*, 22 shtator 2015, <http://www.sipa.gov.ba/en/news/sipa-apprehended-three-individuals-for-forging-of-documents-in-operation-codenamed-art/13225>.
- 24 *Pasoš izdat u Banjaluci: Organizator ubistva vođe 'Škaljarskog klana' u Tursku letio sa dokumentima BiH*, Vecernje Novosti, 23 shtator 2022, <https://vecernjenovosti.ba/99758/hronika/pasos-izdat-u-banjaluci-organizator-ubistva-vođe-skaljarskog-klana-u-tursku-letio-sa-dokumentima-bih>.
- 25 Goran Katić, *Otkup zatvorske kazne u BiH po tarifi od 25 do 50 evra za dan*, Slobodna Evropa, 23 nëntor 2021, <https://www.slobodnaevropa.org/a/zatvor-kazna-otkup-tarifa/31573655.html>.
- 26 Selma Boračić-Mršo, *Službenici u BiH otkupljuju kazne umjesto da idu u zatvor*, Slobodna Evropa, 12 qershor 2019, <https://www.slobodnaevropa.org/a/29995187.html>.
- 27 *Hrvatski i srpski kriminalci kazne plaćaju u BiH*, Glas Srpske, 17 nëntor 2019, https://www.glassrpske.com/lat/novosti/vijesti_dana/hrvatski-i-srpski-kriminalci-kazen-placaju-u-bih/297587.
- 28 Goran Katić, *Zašto je BiH stanica za Čečene u bijegu od mobilizacije?*, Radio Slobodna Europa, 30 dhjetor 2022, <https://www.slobodnaevropa.org/a/cecenija-rusija-bih-evropska-unija/32201177.html>.

GI-TOC-ja bashkorganizoi një konferencë shkencore në Athinë për të trajtuar mungesën e temave të krimit të organizuar në arsimin e lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Thuhet shpesh që ka nevojë për politika të mbështetura në fakte dhe për analiza më të thelluara të krimit të organizuar dhe të bashkëpunimit. Megjithatë, këto tema janë të vështira për t'u hulumtuar, për shkak të natyrës së fshehtë të krimit të organizuar. Për ta trajtuar këtë problematikë, GI-TOC-ja, Organizata Evropiane e së Drejtës Publike (EPLO) dhe Qendra Evropiane për Drejtësi Penale e Universitetit të Panteionit bashkorganizuan në Athinë, midis datave 21-22 tetor 2022, një konferencë shkencore në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Kundër Korrupsionit në Evropën Juglindore dhe për Kriminalistikën në Ballkan. Në këtë konferencë morën pjesë mbi 80 individë, duke përfshirë akademikë nga rajoni, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, studentë të universiteteve greke dhe përfaqësues nga departamenti grek i drejtësisë dhe nga institucione të tjera qeveritare (si Autoriteti Kombëtar i Transparencës), duke krijuar kështu një forum për shkëmbimin e njohurive dhe për krijimin e mundësive të reja të nxënies.

Siç dokumentohet në raportin e radhës të GI-TOC-së, të titulluar "Analiza e hendeikut në kërkimet për ekonominë e paligjshme në Ballkanin Perëndimor", "kapaciteti për hulumtim kriminologjik në fushën e krimit të organizuar, në përgjithësi, është i dobët" në Ballkanin Perëndimor. Analiza e hendeikut tregon se midis vitit 2017 dhe 2021, janë botuar 514 studime për ekonominë e paligjshme, nga studiues të akademisë, shoqëria civile, qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare e rajonale. Revistat akademike zënë vetëm 36% të numrit të përgjithshëm të botimeve. Megjithatë, tezat e doktoraturës zënë më pak se 5% të totalit, çka tregon se hulumtuesit e rinj nuk janë të interesuar për temat që ndërlidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Më tej, hulumtimet financohen kryesisht nga donatorët. Sipas një hulumtuesi: "Po të mos ishte për donatorët, nuk do të kishte fare studime për krimin e organizuar dhe korrupsionin" në Ballkanin Perëndimor.¹

Një prej arsyeve për të cilat në rajon ka pak kërkime rreth krimit të organizuar dhe korrupsionit është se, në të gjitha nivelet arsimore në rajon, nuk ka programe arsimore që përqendrohen te kurset e mësimdhënies për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Kjo mund të ketë ardhur si pasojë e mungesës së mbështetjes së shtetit për studimin e këtyre temave, shkëmbimi i kufizuar i informacioneve dhe mungesa e bashkëpunimit midis akademive në rajon, zhvillimi i pamjaftueshëm i metodologjisë në fakultetet e specializuara gjatë 30 viteve të fundit, mungesa e programeve tërheqëse të studimit ose perceptimi se mungojnë karrierat përkatëse pas diplomimit. Më tej, akademikët në rajon zakonisht botojnë në gjuhët e tyre amtare, çka kufizon përdorimin e tyre nga kolegët e vendeve të tjera të rajonit ose nga gazetarët me renome ndërkombëtare.

Për t'i zgjidhur këto mangësi, simpoziumi në Athinë u mundësoi akademikëve dhe studiuesve të ekspozojnë punimet e tyre dhe të diskutojnë rreth mënyrave për t'i shtrirë më tej kërkimet rreth krimit të organizuar dhe korrupsionit. Gjatë evenimentit dyditor, akademikët që japin mësim në universitetet e Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Qipros, Greqisë, Italisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë patën mundësinë të prezantonin, përpara të pranishmëve dhe atyre që e ndoqën simpoziumin nga interneti, kurset e specializuara të nivelit "master" dhe "doktoraturë" rreth krimit të organizuar dhe korrupsionit, të cilat ofrohen në universitetet e tyre përkatëse. Këtu mund të përmendim programin trevjeçar të doktoraturës të Universitetit të Milanos për "Studime mbi krimin e organizuar". Ata folën për përvojat dhe praktikatat e mira që ndiqen në kuadër të metodologjive kërkimore, shprehive dhe njohurive, dhe patën mundësinë të forconin rrjetet e tyre.

Krahas kësaj, pjesëmarrësit mësuan për burimet që ofrohen nga organizatat ndërkombëtare. Për shembull, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin

prezantoi nismën “Burimi Global për Edukimin Kundër Korrupsionit dhe për Fuqizimin e Rinisë”, që përmban module dhe manuale mësimdhënieje për parandalimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe për kultivimin e integritetit. Këto module dhe manuale janë në dispozicion të akademikëve, arsimtarëve, autoriteteve të parandalimit të korrupsionit dhe rinisë. Përfaqësues të organizatës “Transparency International” në Greqi foli për përdorimin e rasteve të korrupsionit të madh për qëllime mësimdhënieje dhe prezantoi “Indeksin e perceptimit të korrupsionit”.² Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit shtjelloi më tej rolin që luan arsimi në përmirësimin e bashkëpunimit rajonal kundër korrupsionit, ndërsa Akademia Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit bëri një prezantim për kurset e specializuara “master” për parandalimin e korrupsionit. Përfaqësuesit e organizatës “Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit” folën për përpjekjet e gjera të organizatës për të përfshirë rininë dhe dhanë kontributin e tyre në diskutimin rreth ndikimeve që mund të ketë te krimi i organizuar legalizimi i kanabisit në rajon. Së fundi, por po aq e rëndësishme, GI-TOC-ja prezantoi raportin kryesor të saj, “Indeksin Global të Krimit të Organizuar”,³ si dhe gjetjet kryesore nga analiza e hendekut të raporteve dhe botimeve të fundit rreth parandalimit të korrupsionit në Ballkanin Perëndimor, domethënë serinë

“Infrastruktura e integritetit”.⁴ Kjo analizë pritet të botohet së shpejti.

Një prej gjërave që u përmenden më së shpeshti gjatë simpoziumit ishte nevoja për më shumë edukim rreth korrupsionit dhe krimit të organizuar me qëllim të pasurimit të bazës së njohurive mbi këto tema; përmirësimit të parandalimit të tyre dhe krijimit të një kulture integriteti. Kjo kërkesë u ngrit edhe në Konferencën e Shibenikut në maj të vitit 2022 për “Kulturën e integritetit”, ku morën pjesë ministra të drejtësisë, përfaqësues të agjencive të specializuara për luftën kundër korrupsionit, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, akademikë, përfaqësues të agjencive ligj-zbatuese dhe të shoqërisë civile nga Ballkani Perëndimor dhe rajoni. Sa më herët të mësojnë studentët dhe nëpunësit civilë për dëmet dhe pasojat e krimit të organizuar dhe korrupsionit, aq më të mëdha do të jenë gjasat për ngushtimin e hendekut midis sistemit arsimor dhe tregut të punës në këto fusha.

Një tjetër arsye pse duhet përmirësuar i arsimi i lartë në lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin është rritja e numrit të ekspertëve që mund të zënë vendet e përshtatshme të punës në sistemin e drejtësisë penale dhe në agjencitë ligj-zbatuese, si dhe në fusha më të



Constantine Palicarsky, Ugljesa Zvekic, Dimitris Ziouvas dhe John Collins marrin pjesë në konferencën shkencore në Athinë në tetor të vitit 2022, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit në fushën e kërkimeve rreth krimit të organizuar.

Foto: E dhënë

specializuara siç janë inteligjencia financiare, siguria kibernetike dhe kriminalistika. Megjithatë, sfida është që programi mësimor të hartohet në mënyrë të tillë që studentët të pajisjen me shprehitë dhe aftësitë e nevojshme për të analizuar dhe luftuar krimin në botën e vërtetë.

Rritja e bazës së njohurive mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin mund të çojë edhe në përmirësimin e politikave që mbështeten në prova dhe mund të kontribuojë në reagime strategjike më efektive. Në këtë kuptim, një prej sfidave është të shkallmohen barrierat midis akademisë, shoqërisë civile dhe agjencive ligj-

zbatuese me qëllim që të nxitet më shumë gërshetimi i fushave përkatëse, dhe kjo në të mirën e tyre të ndërsjellë.

Disa prej ideve që mund të ndiqen më vonë janë shkollat verore të specializuara për krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe hartimi i një plani mësimor të përshtatur. Modeli i simpoziumit, që është testuar në Evropën Juglindore, mund të imitohet dhe të zbatohet edhe në pjesë të tjera të botës, me qëllim nxitjen e shkëmbimit të njohurive midis akademisë, organizatave ndërkombëtare dhe nxënësve, si në nivel rajonal, ashtu edhe në nivel global.

Shënime

- 1 Shih "Analizën e hendekut në kërkimet për ekonomitë e paligjshme në Ballkanin Perëndimor", GI-TOC, që pritet të dalë së shpejti.
- 2 Shih: <https://www.transparency.org/en/cpi/2021>.
- 3 Shih: <https://ocindex.net>.
- 4 Shih, për shembull, Uglješa Ugi Zvekić dhe Sunčana Roksandić Vidlička, *Corruption and anti-corruption pledges in the Western Balkans*, GI-TOC, tetor 2020, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/10/Infrastructure-of-Integrity-GI-TOC.pdf>.

Mirënjohje

“Buletini i rreziqeve” është rezultat i punës së Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore (“SEE-Obs”) të Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar.

SEE-Obs-ja është platformë që bashkon dhe fuqizon aktorët e shoqërisë civile në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Qëllimi i platformës është t’i mundësojë shoqërisë civile të identifikojë, analizojë dhe vendosë në

hartë prirjet kriminale dhe ndikimin që ato kanë në prurjet e paligjshme financiare, qeverisje, zhvillim, marrëdhëniet ndëretnike, sigurinë dhe shtetin ligjor. SEE-Obs-ja mbështet shoqërinë civile në monitorimin që ajo u bën dinamikave kombëtare dhe prirjeve më të gjera rajonale dhe ndërkombëtare të krimin të organizuar. Platforma “SEE-Obs” u themelua si rezultat i Samitit të vitit 2018 të Vendeve të Ballkanit në Londër, në kuadër të Procesit të Berlinit.

Buletinet e Rreziqeve janë publikime periodike nga observatorët tanë rajonalë, në bashkëpunim me rrjete të shoqërisë civile për të paraqitur të dhëna të reja dhe për të kontekstualizuar prirjet e rrjeteve të krimit të organizuar, tregtisë së paligjshme, dhe reagimit të shtetit ndaj tyre. Nëse doni të abonoheni për të marrë numrat e ardhshëm të "Buletinit të rreziqeve", ju lutemi regjistrohuni këtu ose dërgoni email në almedina.dodic@globalinitiative.net.

MBI "INCIATIVËN GLOBALE"

Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar është një rrjet mbarëbotëror, i përbërë nga më shumë se 600 ekspertë të shpërndarë nëpër të gjithë globin. Iniciativa Globale ka krijuar një platformë për nxitjen e një debati më të gjerë dhe promovimin e përjasjeve inovative, për të krijuar një bazë të fortë për hartimin e një strategjie në nivel global kundër krimit të organizuar.

www.globalinitiative.net

Ky publikim u realizua me mbështetjen financiare të Fondit të Mbretërisë së Bashkuar për Konflikt, Stabilitet dhe Siguri. Përgjegjësia mbi përmbajtjen e këtij publikimi bie vetëm mbi GI-TOC, dhe përmbajtja nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Mbretërisë së Bashkuar.



**GLOBAL
INITIATIVE**
AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME